



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

**RAPORT**  
*(Përfundimtar)*

**PËR**

**MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË GJATË ZHVILLIMIT TË PROCEDURAVE  
TË PLOTËSIMIT TË POZICIONEVE TË LIRA NË SHËRBIMIN CIVIL DHE  
VLERËSIMIN E REZULTATEVE NË PUNË  
TË NËPUNËSVE CIVIL**

**NJËSIA E VETËQEVERISJES VENDORE**

**BASHKIA KAMËZ**

**Tiranë, Dhjetor 2022**

## RAPORT

### **Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Kamëz.**

#### **Hyrje**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes dhe të Vendimit nr. 48, datë 05.04.2022, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në institucionin Bashkia Kamëz”*, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në institucionin Bashkia Kamëz, Tiranë.

Pas riorganizimit administrativo-territorial të ndodhur në vitin 2015, njësitë e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, organizohen dhe funksionojnë sipas përcaktimeve të dispozitave të ligjit nr. 139/2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*. Sipas këtij ligji, njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë bashkitë e qarqet, në të, përcaktohen funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre.

Në nenin 5, *“Njësitë e vetëqeverisjes vendore”* të këtij ligji, bashkia përkufizohet si, *“njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, që përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh, ku shtrirja territoriale, emri dhe qyteti qendër i saj, përcaktohen me ligj”*.

Më tej, në nenin 6, *“Nënndarjet e bashkisë”*, të këtij akti ligjor, përcaktohet se:

*“Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri, përcaktohen me ligj”;*

Ndërsa në nenin 65, *“Administrata e njësisë administrative”*, të ligjit nr. 139/2015, normohet se, *“Struktura dhe organika e administratës së njësisë administrative janë pjesë të strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë”*.

Në rastin konkret, Bashkia Kamëz, përbëhet nga njësia administrative Kamëz (bashkia në qendër; 1 njësi administrative Paskuqan, si dhe 3 lagje), të përcaktuar në ligjin

nr.115/2014, *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*.

Struktura dhe organika e këtyre njësive administrative, janë pjesë përbërëse e strukturës dhe organikës së administratës së Bashkisë Kamëz, e në këto rrethana, kryerja e mbikëqyrjes, është shtrirë edhe në njësitë administrative.

Në mbështetje të dispozitave ligjore të sipërcituara rezulton se, të gjithë punonjësit që janë të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, përfshihen në nenin 2, *“Fusha e veprimit”*, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke filluar që nga momenti i rekrutimit, pra, pranimit në shërbimin civil dhe duke vazhduar me të gjitha procedurat që ndiqen gjatë aplikimit të instituteve të Ligjit.

Nga sa më sipër, duke qenë se ky institucion përfshihet në skemën e shërbimit civil, atëherë ai është pjesë e subjekteve që mbikëqyren nga Komisioneri.

Procesi i mbikëqyrjes në këtë institucion, filloi në datën 06.04.2022 në zbatim të Programit të Mbikëqyrjes nr. 266/1 prot., datë 05.04.2022, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar institucionit me shkresën nr. 266/2 prot., datë 05.04.2022, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Bashkia Kamëz”*.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike të administrimit të këtij procesi.

Ndërkohë, Komisioneri, nëpërmjet disa informacioneve të ardhura nga nëpunës civilë të Bashkisë Kamëz, u vu në dijeni për parregullsi të lejuara gjatë realizimit të procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë të këtij institucioni.

Mbi këtë bazë, me Vendimin nr. 84 (266/7 prot.), datë 14.06.2022, të Komisionerit, *“Për një shtesë në objektin e mbikëqyrjes filluar me vendimin nr. 48 (266 prot.), datë 05.04.2022, të Komisionerit “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në institucionin Bashkia Kamëz”*, objekti i programit të mbikëqyrjes nr. 266/1 prot., datë 05.04.2022, është shtuar duke përfshirë në këtë proces edhe mënyrën e

funksionimit dhe zbatimit të institutit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë.

Programi shtesë i mbikëqyrjes nr. 266/9 prot., datë 14.06.2022, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë realizimit të procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë, i është njoftuar Kryetarit të Bashkisë Kamëz me shkresën nr. 266/10 prot., datë 14.06.2022, *“Njoftim për shtimin e objektit të mbikëqyrjes të filluar me programin e mbikëqyrjes nr. 266/1 prot., datë 05.04.2022”*.

Për këtë arsye, në përmbajtje të këtij raporti është analizuar dhe trajtuar zbatimi i rregullave të administrimit të shërbimit civil gjatë realizimit të procedurave të konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, si dhe vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civilë për periudhat janar - qershor dhe korrik - dhjetor, të vitit 2021.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët Luiseda Zhapa, Behare Hoxha, Inesa Çani dhe nga Ina Skënderi, specialist IT, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Kamëz.

Ky material, me shkresën nr. 266/11 prot., datë 19.09.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në institucionin Bashkia Kamëz, në përfundim të mbikëqyrjes së ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil dhe vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civil”*, u dërgua për njohje, pranë institucionit, duke i lënë 1 muaj kohë, për të paraqitur observacionet e tyre në lidhje me gjetjet e grupit të punës.

Në vijim, institucioni i mbikëqyrur me shkresën e protokolluar pranë Komisionerit me nr.266/12 prot., datë 27.09.2022, ka kërkuar zgjatje të afatit për dërgimin e observacioneve mbi projektraportin, për shkak të ngarkesës në punë dhe stafit të reduktuar.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Komisioneri me shkresën nr. 266/13 prot., datë 10.10.2022, ka vendosur të shtyjë afatin për paraqitjen e observacioneve nga Bashkia Kamëz, me 1 muaj, nga data e përfundimit të afatit të vendosur.

Subjekti i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin, me shkresën nr. 8557/1 prot., datë 18.11.2022, *“Kthim përgjigje”*, të protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr.266/14 prot., datë 18.11.2022, e ka dërguar atë të firmosur, pa vërejtje, duke sqaruar se, gjatë kësaj periudhe ka rregulluar ligjshmërinë në lidhje me problematikat e evidentuara në projektraportin e dërguar, sa i takon:

- ✓ Deklarimit të statusit të punësimit, si “*nëpunës civil*” për **15** punonjës;
- ✓ Përfundimin e periudhës së vlerësimit dhe deklarimin e statusit të punësimit për **12** punonjës;
- ✓ Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për **18** punonjës dhe shpalljen e vendeve vakant për **10** pozicione pune;
- ✓ Ndryshimin e statusit juridik të rregullimit të marrëdhënies së punës, për pozicionet e punës ku janë të punësuar **13** punonjës, duke i nxjerrë këto pozicione nga shërbimi civil, si dhe duke e bërë rregullimin e marrëdhënies së punësimit sipas legjislacionit të së Drejtës së Punës.
- ✓ Rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, për **3** punonjës, ku kanë pasur emërimin në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

Duke qenë se, këto veprime të kryera nga njësia përgjegjëse, nuk janë të shoqëruara nga institucioni me aktet administrative përkatëse për të provuar faktin e pretenduar, ato do të jenë objekt i verifikimit të mëtejshëm, në vijim të procesit të mbikëqyrjes në këtë institucion, pas miratimit të raportit përfundimtar, e për këtë arsye nuk ndryshon arsyetimi në lidhje me to në raportin përfundimtar.

### **Qëllimi i mbikëqyrjes**

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të Ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

### **Objekti i mbikëqyrjes**

1. Si është kuptuar dhe zbatuar Ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

2. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
3. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, nëpërmjet konkurrimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 22 dhe akteve nënligjore në lidhje me dy fazat e këtij procesi:
  - verifikimi paraprak nga njësia përgjegjëse, nëse konkurrentët i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;
  - vlerësimi i kandidatëve nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit.
4. Emërimet në shërbimin civil pas përfundimit të procesit të konkurrimit dhe menaxhimi i listës së kandidatëve fitues që kanë arritur pikët, por që nuk janë emëruar. Evidentimi i rasteve të emërimit pa konkurrim, në kundërshtim me kërkesat e nenit 23, të ligjit për nëpunësin civil.
5. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*si janë zbatuar detyrimet e nëpunësit dhe eprorit si dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
6. Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive dhe respektimi i kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 25, të ligjit për nëpunësin civil, gjatë zhvillimit të kësaj procedure nga Komisioni i Brendshëm.
7. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese dhe respektimi i procedurave të kërkuara nga neni 26, i ligjit për nëpunësin civil, nga njësia përgjegjëse dhe Komiteti i Pranimit gjatë zhvillimit të dy fazave të konkurrimit:
  - verifikimit paraprak;
  - vlerësimi i kandidatëve.
8. Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese dhe respektimi i kërkesave të nenit 32, të ligjit për nëpunësin civil nga ana e titullarit të institucionit (*respektimi i kufirit prej 15% të pranimit nga jashtë shërbimit civil*); respektimi i kërkesave ligjore nga ana e njësisë përgjegjëse për organizimin e konkurrimit dhe respektimi i procedurave të konkurrimit nga ana e Komisionit të Përhershëm të Pranimit, gjatë realizimit të procesit.

9. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë realizimit të procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të Kreut XI, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, nga ana e zyrtarëve të ngarkuar prej ligjit me detyra specifike të administrimit të këtij procesi.
10. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar.

### **Metodologjia e mbikëqyrjes**

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin e dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivën e institucionit, si dhe në sektorin e shërbimeve mbështetëse, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës, për institucionin Bashkia Kamëz.
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe përmbajtja e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.
- U verifikuan përshkrimet e punës për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, nëse ato janë të hartuara në përputhje me formatin standard të miratuar.
- U verifikuan formularët e vlerësimit të punës në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civilë në periudhë prove dhe nëse ky proces, është kryer sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës, të çdo nëpunësi të rekrutuar rishtas, për të provuar përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës, si arsimi, përvoja në punë e të tjera.

Konstatimet janë të materializuara si tabela më vete (*Aneksi 1; Aneksi 2; Tabela 1*), të cilat janë pjesë e këtij raporti.

- I. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.

1. *Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes.*

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Administrimi i shërbimit civil në këtë institucion, pas riorganizimit të organeve të qeverisjes vendore, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 139/2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”, kryhet mbi bazën e strukturave organizative të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë, më konkretisht:

Në nenin 54, të ligjit, ku parashikohen detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak, në germën “*dh*”, përcaktohet se, **Këshilli Bashkiak**, miraton buxhetin si dhe numrin maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë.

Ndërsa, në nenin 64, të germën “*j*”, përcaktohet se, **Kryetari i Bashkisë**, miraton strukturën, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nisur nga këto përcaktime ligjore, si dhe nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, (në datën 26.02.2014), Bashkia Kamëz, ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 54, datë 19.11.2013, të Këshillit Bashkiak “*Për miratimin e strukturës organizative të aparatit të bashkisë, nivelit të pagave për punonjësit e aparatit, miratimin e numrit të ndërlydhësve me komunitetin si dhe pagesën e tyre për vitin 2014*”.



Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, aparati administrativ i bashkisë, në këtë periudhë, ka pasur gjithsej **121** pozicione pune, nga të cilat, **88** pozicione pune vlerësohen si pjesë e shërbimit civil.

Në momentin e mbikëqyrjes, rezultoi se, Këshilli Bashkiak pranë Bashkisë Kamëz me Vendimin nr. 130, datë 22.12.2021, *“Për miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë Kamëz dhe ndërmarrjeve të vartësisë për vitin 2022”*, ka miratuar nivelin e pagave për punonjësit e bashkisë dhe ndërmarrjeve në varësi të saj, si dhe me Vendimin nr. 132, datë 22.12.2021, *“Për miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2022, 2023, 2024”*, ka miratuar buxhetin e bashkisë për këto vite, si dhe numrin e punonjësve të saj sipas pikës 13, të këtij vendimi.

Më tej, me shkresën nr. 2070/1 prot., datë 06.01.2022, *“Verifikim ligjshmërie”*, Prefekti i Qarkut Tiranë, bazuar në ligjin nr. 107/2016, *“Për Prefektin”* dhe ligjin nr. 139/2013, *“Për vetëqeverisjen vendore”* është shprehur për ligjshmërinë e Vendimeve me nr. 126 deri nr. 132, datë 22.12.2021, të miratuara nga Këshilli Bashkiak Kamëz, duke i cilësuar të dy vendimet e sipërcituara nr. 130, datë 22.12.2021 dhe nr. 132, datë 22.12.2021, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë të institucioneve të vetëqeverisjes vendore.

Pas verifikimit të ligjshmërisë së vendimeve të Këshillit Bashkiak, me Vendimin e Kryetarit nr. 79, datë 26.01.2022, *“Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz”*, (nr. 729 prot., datë 26.01.2022), është miratuar struktura organizative e bashkisë, për vitin 2022. Në vijim, kjo strukturë ka pësuar ndryshime me Vendimin nr.203, datë 24.02.2022, *“Për një ndryshim në Vendimin nr. 79 prot., datë 26.01.2022, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz””*, të Kryetarit, sipas së cilës është vendosur ndryshimi i varësisë së *“Sektorit MTPM-së e Bordit të Kullimit”* nga *“Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Kadastrës”*, pranë *“Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore”*.

Në vijim të veprimtarisë së institucionit, me Vendimin nr. 262, datë 15.03.2022, *“Për një ndryshim, në vendimin nr. 203 prot., datë 24.02.2022, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz””*, të Kryetarit, është ndryshuar përsëri struktura e institucionit për shkak të krijimit të *“Drejtorisë MTPM e Bordit të Kullimit”*; shkurtimi i një pozicioni *“Drejtor i Përgjithshëm”*; si dhe ndryshimin e emertimit të drejtorisë nga *“Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Kadastrës”*, në *“Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore”*.

Gjatë administrimit të dokumentacionit për ndryshimin e strukturave të institucionit, nuk u vu në dispozicion të grupit të punës, asnjë material shkresor justifikues për nevojën e ndryshimit të strukturës, e cila rezultoi se ka pësuar disa herë ndryshime brenda 3 mujorit

të parë të vitit 2022, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 30, të VKM-së nr. 893, datë 17.12.2014, *“Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”*, të cilit njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet ti referohen për analogji.

Gjithashtu, u konstatua se, vendimet e nxjerra nga Kryetari për ndryshimin e strukturës, nuk janë dërguar pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë për të verifikuar ligjshmërinë e aktit normativ nga ky i fundit, në përputhje me detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 8, germa a), të ligjit nr. 107/2016, *“Për Prefektin e Qarkut”*. Rezulton se, struktura në fuqi nuk është shoqëruar me hartimin e organigramës së institucionit.

Gjithashtu, në të gjitha rastet e ndryshimit të strukturës, përshkrimet e reja për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, nuk i janë bashkëlidhur aktit, në përputhje me përcaktimet e pikës 14, të Kreut IV, të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.

**Konkluzion:** Në hartimin e strukturës në fuqi, në Bashkinë Kamëz nuk janë respektuar kërkesat e VKM-së nr. 142, datë 12.03.2014, i ndryshuar, sa i takon përshkrimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës, pasi nuk ka një ndarje të qartë të pozicioneve të punës që normohen nga shërbimi civil dhe pozicioneve të normuara sipas Kodit të Punës.

Sa i takon ndarjeve organizative brenda strukturës, rezultoi se, nuk janë realizuar në përputhje me përcaktimet ligjore të VKM-së nr. 893, datë 17.12.2014, *“Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”*.

Megjithatë, për vlerësimin e strukturës së Bashkisë Kamëz, Komisioneri ka ngritur një grup pune, i cili po e analizon atë, me qëllim ofrimin e asistencës pranë institucionit, për hartimin e saj në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

Sipas strukturës së fundit të miratuar me Vendimin nr. 262, datë 15.03.2022, *“Për një ndryshim, në vendimin nr. 203 prot., datë 24.02.2022, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz”*”, nga Kryetari i Bashkisë, institucioni Bashkia Kamëz ka gjithsej **266** pozicione pune, të organizuara në këtë mënyrë:

- ✓ **1** pozicion i zgjedhur **Kryetar**;

*Funksionet politike ku bën pjesë kabineti i Kryetarit, ato ndahen:*

- ✓ **3** pozicione pune **Zv/Kryetar**;
- ✓ **1** pozicion pune **Sekretar i Kryetarit**;
- ✓ **5** pozicione pune **Këshilltar**
- ✓ **147** pozicione pune janë **pjesë e shërbimit civil**;
- ✓ **109** pozicione pune që normohen nga **Kodi i Punës**;

Sipas kësaj strukture, **147** pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, janë të ndara në kategoritë e nëpunësisë civile si mëposhtë:

*Tabela nr. 1 Ndarja e pozicioneve të punës në shërbimin civil në Bashkinë Kamëz, sipas strukturës dhe organikës në fuqi*

<b>Klasifikimi i pozicioneve të shërbimit civil</b>				
<i>Drejtor i Përgjithshëm (IIa)</i>	<i>Drejtor Drejtorie (IIb)</i>	<i>Përgjegjës Sektori (IIIa/1)</i>	<i>Specialist (IIIb)</i>	<i>Specialist (IVa)</i>
<b>1</b>	<b>17</b>	<b>33</b>	<b>80</b>	<b>16</b>
<b>147 pozicione pune në shërbimin civil</b>				

Rezulton se, nga pozicionet e punës në shërbimin civil, në momentin e fillimit të mbikëqyrjes rezultojnë të lira **12** pozicione pune, të ndara në kategoritë si më poshtë vijon:

- **1** pozicion i kategorisë së nivelit të mesëm drejtues (Drejtor Drejtore);
- **3** pozicione të kategorisë së nivelit të ulët drejtues (Përgjegjës Sektori);
- **8** pozicione të kategorisë ekzekutive (Specialist).

Në rastin konkret, **147** pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në institucionin Bashkia Kamëz, paraqiten në këtë raport:

- Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, është **1** pozicion pune, ose rreth **1 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicioneve “*Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Publike*”.

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, janë **17** pozicione pune, ose rreth **12%** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “*Drejtor Drejtorie*”.
  - Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, janë **33** pozicione pune, ose rreth **22 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “*Përgjegjës Sektori*”.
  - Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **96** pozicione pune, ose **65 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “*Specialist*”.
2. **Si është kuptuar dhe zbatuar neni 67, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij**

Një aspekt i rëndësishëm i procesit të mbikëqyrjes është verifikimi i punonjësve të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune në pozicione pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil dhe u është deklaruar statusi i nëpunësit civil, pas plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Nisur nga fakti që institucioni i mbikëqyrur është pjesë e shërbimit civil, atëherë deklarimi si nëpunës civilë ekzistues për çdo punonjës të këtij institucioni, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur kohëzgjatja e marrëdhënies së punës, nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, për të përcaktuar kategorinë si nëpunës civil (më shumë se 1 vit), apo nëpunës civil në periudhë prove (më pak se një vit), si dhe organi që realizon deklarin e statusit të punësimit (*njësia përgjegjëse*).

Dispozitat e sipërpërmendura, përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarin e statusit të punësimit, pas verifikimit të procedurës së punësimit për të gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Mbështetur në bazën ligjore të sipërcituar, Komisioneri, në vitin 2016, ka nisur mbikëqyrjen në institucionin Bashkia Kamëz, ku si objekt ka pasur mbikëqyrjen e ligjshmërisë gjatë procesit të deklarin të statusit të punësimit për punonjësit e kësaj bashkie, nga ana e njësisë përgjegjëse, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, që përkon me (datë 26.02.2014). Në përfundim të mbikëqyrjes së zhvilluar, Komisioneri, ka nxjerr Raportin dhe Vendimin paralajmëruar nr. 13, datë 29.01.2016, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të*

*mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Kamëz*”, në të cilin janë materializuar konstatimet dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse në lidhje me këtë proces.

Sipas përmbajtjes së këtij Raporti, ka rezultuar se, nga ana e njësisë përgjegjëse, pranë kësaj bashkie, janë nxjerr aktet e deklaramit të statusit të punësimi, si “*nëpunës civil*”, për **41** punonjës të kësaj bashkie.

Aktualisht, në momentin e realizimit të mbikëqyrjes në Bashkinë Kamëz, vijojnë marrëdhënien e punësimi në shërbimin civil, **25** punonjës, për të cilët është deklaruar statusi i punësimi, nga ana e njësisë përgjegjëse, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe **14** prej tyre, mbajnë të njëjtin pozicion pune ku i është deklaruar statusi si “*nëpunës civil*”.

Nga këqyrja e akteve të emërimit në dosjen personale të secilit punonjës, grupi i punës konstatoi se, për punonjësit:

1. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 242, datë 11.12.2013, të Kryetarit, si “*Specialist i Informacionit + Pritje*”, me aktin nr. 50 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi si “*nëpunës civil në periudhë prove*”, në pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë Ndërlidhëse e Komunitetit me Gjendjen Civile.
2. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 123, datë 28.03.2013, të Kryetarit, si “*Specialist i Mirëmbajtjes Elektrike*”. Komisioneri, me vendimin paralajmërues nr.13, datë 29.01.2016, ka kërkuar të deklarohet statusi si “*nëpunës civil*”, pasi në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit 152/2013, i ndryshuar, ka qenë i punësuar në pozicionin e punës “*Specialist i Mirëmbajtjes Elektrike*”, për një periudhë kohore më tepër se një vit.
3. \*\*\*\*\*, punonjësi ka filluar punë me aktin nr. 31, datë 09.05.2013, “*Specialist në Zyrën e Urbanistikës*”, pranë Komunës Paskuqan, sipas librezës së punës data e fillimit të efekteve financiare është 14.05.2013, me aktin nr.11/2, datë 05.01.2015, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi si “*nëpunës civil në periudhë prove*”. Komisioneri në vendimin paralajmërues nr. 13, datë 29.01.2016, i ka lënë detyrë njësisë përgjegjëse, pranë Bashkisë Kamëz, të shprehet në lidhje me vazhdimin e marrëdhënies së punësimi, pasi të jenë plotësuar detyrimet ligjore të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar). Punonjësi ka punuar pranë Komunës Paskuqan dhe më pas pranë Bashkisë Kamëz, në mënyrë të pandërprerë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil. Aktualisht, mban pozicionin “*Specialist në Sektorin e Investimeve dhe Monitorimit të Infrastrukturës*”, pranë Bashkisë Kamëz, emëruar me urdhrin nr. 6, datë 03.01.2019, të Kryetarit.

4. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 79, datë 18.02.2013, të Kryetarit, "Specialist Protokoll", rezulton se, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, që përkon me datën 26.02.2014, punonjësja ishte e emëruar në mënyrë të pandërprerë në këtë pozicion pune, për një periudhë kohore më tepër se një vit, si rrjedhim, duhej të deklarohet statusi si "nëpunës civil", në këtë pozicion pune.

**Konkluzion:** Sa i takon punonjësve të përmendur më lart, në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohen në mënyrë të shprehur kërkesat për deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit e emëruar në pozicione të shërbimit civil, duke qenë se këta punonjës në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, (datë 26.02.2014), kanë qenë në pozicione të shërbimit civil, duhet t'i deklarohet statusi i punësimit, konkretisht:

- ✓ Për punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, të cilët kanë pasur një kohëzgjatje të marrëdhënies së punës në të njëjtin pozicion, nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, (më shumë se 1 vit), ti deklarohet statusi "nëpunës civil", në pozicionin ku kanë qenë të emëruar në atë moment ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.
- ✓ Punonjësve \*\*\*\*\*, të cilës i është deklaruar statusi si "nëpunës civil në periudhë prove", (akti nr. 50 prot., datë 17.07.2014) dhe \*\*\*\*\* deklaruar statusi si "nëpunës civil në periudhë prove", (akti nr. 11/2 prot., datë 05.01.2015), duhet t'i verifikohet nga ana e njësisë përgjegjëse, nëse janë përmbushur detyrimet e përcaktuara ligjore gjatë periudhës së provës, të parashikuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", i ndryshuar, dhe ti deklarohet statusi si "nëpunës civil", në pozicionin ku i është deklaruar statusi në periudhë prove, nëpërmjet një akti administrativ të posaçëm, që është vendimi i eprorit direkt.

### **3. Mënyra e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil në momentin e realizimit të mbikëqyrjes**


Nga kontrolli i ushtruar, si dhe nga materialet që na janë vënë në dispozicion nga njësia e burimeve njerëzore, rezulton se **135** pozicione pune në administratën e institucionit, të cilat janë pjesë e shërbimit civil janë të zëna në momentin e realizimit të mbikëqyrjes dhe përqindja e tyre në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, që është **147** pozicione pune, zë **92 %**. Mënyra e plotësimit të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, paraqitet si më poshtë:

- **14** pozicione pune, që zënë rreth **10 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës të plotësuara, pjesë e shërbimit civil, janë të zëna nga nëpunës, të cilët data 26.02.2014, që është edhe momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, i ka gjetur në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, ku ende vijojnë të jenë të punësuar.
- **60** pozicione pune, që zënë rreth **44 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës të plotësuar pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar nëpërmjet konkurrimit për pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
- **15** pozicione pune, që zënë rreth **11 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës të plotësuara pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar nga nëpunës civil ekzistues, të cilët, në pozicionin aktual, janë emëruar me ngritje në detyrë duke zbatuar procedurat e konkurrimit të përcaktuara nga neni 26, i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar; Vendimi nr. 242, datë 18.03.2015, i Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar.
- **20** pozicione pune, që zënë rreth **15 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës të plotësuara pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar nëpërmjet konkurrimit me kandidatë nga jashtë, në përputhje me pikën 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
- **1** pozicion pune, që zë rreth **1 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës të plotësuara pjesë e shërbimit civil, është plotësuar nëpërmjet konkurrimit me kandidatë nga jashtë, ngritje në detyrë, nivel i lartë drejtues, në përputhje me nenin 32, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
- **24** pozicione pune, që zënë rreth **18 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës të plotësuara pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar nga punonjës me akte të përkohshme emërimi nga Kryetari i Bashkisë, në kundërshtim me procedurat e konkurrimit të përcaktuara nga neni 23, 24 dhe 25, i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe Vendimi nr. 243, datë 18.03.2015, i Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar.

- 1 pozicion pune, që zë rreth **1 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës të plotësuara pjesë e shërbimit civil, është plotësuar me studentë të ekselencës, sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 586, datë 30.08.2019, “Për punësimin e përkohshëm të studenteve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, i ndryshuar.

Në vijim po e paraqesim në mënyrë grafike situatën e plotësimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil në Bashkinë Kamëz.

Grafik nr. 1 Mënyra e plotësimit të pozicioneve në shërbimin civil në momentin e mbikëqyrjes



**II. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë**

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, grupi i punës, ka këqyru procedurat e konkurrimit për pranimit në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil, në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues, si dhe në pozicionet e kategorisë së nivelit të lartë drejtues në institucionin Bashkia Kamëz për të



gjithë punonjësit që janë të emëruar në pozicione të shërbimit civil, në momentin e realizimit të mbikëqyrjes.

### **1. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimi në shërbimin civil**

Në zbatim të detyrimeve të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Njësitë e qeverisjes vendore dhe çdo institucion i pavarur, jo më vonë se muaji shkurt, miratojnë planet e veta të pranimeve vjetore. Planet vjetore të miratuara sipas kësaj pike publikohen”, si dhe Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”, institucioni duhet të miratojë planin vjetor të pranimi në pozicionet e lira pjesë e shërbimit civil në bazë të të cilave administrohet i gjithë procesi i rekrutimit.

Përgatitja e tij në mënyrë të detajuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore, përbën një garanci për zhvillimin e gjithë procedurave të konkurrimit.

Nga dokumentacioni i këqyrrur për periudhën objekt mbikëqyrjeje, në lidhje me miratimin e këtij plani, rezulton si më poshtë:

#### **➤ Plani i Pranimi në Shërbimin Civil viti 2019 dhe vitin 2020**

Konstatohet se, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kamëz për vitin 2019 dhe për vitin 2020, nuk ka hartuar Planin e Pranimi në Shërbimin Civil, duke mos respektuar detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 18, të Ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar dhe VKM-në nr. 108, datë 26.02.2014.

#### **➤ Plani i Pranimi në Shërbimin Civil viti 2021**

Për vitin 2021, institucioni Bashkia Kamëz, në përputhje me kërkesat e nenit 18, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 26.02.2014, “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”, ka miratuar Planin Vjetor të Pranimi në Shërbimin Civil, me Vendimin nr. 44 prot., datë 21.01.2021, të Kryetarit të Bashkisë, në të cilin janë përfshirë **19 pozicione** të lira në shërbimin civil, për tu plotësuar për vitin 2021, të paraqitura si më poshtë vijon:

- 2 pozicione kategoria niveli i lartë drejtues;
- 4 pozicione kategoria niveli i mesëm drejtues;
- 2 pozicione kategoria niveli i ulët drejtues;
- 11 pozicione kategoria niveli ekzekutiv;

➤ Plani i Pranimit në Shërbimin Civil viti 2022

Bashkia Kamëz për vitin 2022 ka miratuar Planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil, me Vendimin “Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2022”, nr.161 prot., datë 08.02.2022, të Kryetarit të Bashkisë.

Rezulton se, për këtë vit janë parashikuar për tu plotësuar gjithsej **24 pozicione** të lira në shërbimin civil, të ndara në kategoritë e poshtë shënuara:

- **1** pozicion kategoria niveli i lartë drejtues;
- **2** pozicione kategoria niveli i mesëm drejtues;
- **6** pozicione kategoria niveli i ulët drejtues;
- **15** pozicione kategoria niveli ekzekutiv;

Nga sa më sipër, për periudhën objekt mbikëqyrje, 2019-2022, rezulton se është miratuar plani i pranimit në shërbimin civil vetëm për vitet 2021-2022, e sipas këtyre akteve janë planifikuar 43 pozicione të lira për rekrutim, sipas kategorive të paraqitura në tabelën në vijim:

*Tabela nr. 2 Pozicionet e shërbimit civil, të planifikuara për tu plotësuar gjatë periudhës shtator 2019- mars 2022, sipas planit të pranimeve*

Pozicionet e lira të ndara në kategori	Numri i pozicioneve sipas Planit të Pranimit në secilin vit				Totali numri i pozicioneve të planifikuara të ndara në kategori
	2019	2020	2021	2022	
<i>Kategoria e nivelit të lartë drejtues</i>	-	-	2	1	<b>3</b>
<i>Kategoria e nivelit të mesëm drejtues</i>	-	-	4	2	<b>6</b>
<i>Kategoria e nivelit të ulët drejtues</i>	-	-	2	6	<b>8</b>
<i>Kategoria ekzekutive</i>	-	-	11	15	<b>26</b>
<b>Totali numri i pozicione të planifikuara në secilin vit</b>	-	-	<b>19</b>	<b>24</b>	<b>43</b>

Rezulton se, subjekti i mbikëqyrur në zbatim të nenit 22, 25, 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në zbatim të planeve të rekrutimit, për vitet në të cilat është miratuar, ka organizuar konkurrime për plotësimin e pozicioneve të lira të nivelit ekzekutiv, të ulët dhe të mesëm drejtues, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele,

ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil, për pozicionet e planifikuara në planet vjetore të pranimit, si dhe për pozicionet e tjera vakante të paparashikuara në planin e pranimit.

Gjatë këqyrjes së akteve që dokumentojnë procedurat e konkurrimit të zhvilluara nga njësia përgjegjëse, u konstatua se, për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues është përdorur parashikimi i pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e cila përcakton se, pozicionet e kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues mund të plotësohen me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, duke respektuar që të mos kaloj kufirin e 20 %, të numrit total të vendeve të lira për çdo vit kalendarik.

Gjithashtu, sipas dokumentacionit të konkurrimit të vënë në dispozicion, u konstatua se, një pozicion i nivelit të lartë drejtues, me emërtesën “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme”, është plotësuar në respektim të pikës 1, të nenit 32, e cila sanksionin se procedura e pranimit për këtë kategori nëpunësish mund të jetë e hapur edhe për kandidatët jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, por në asnjë rast ky numër nuk mund të jetë më shumë se 15 % të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kategorisë së lartë drejtuese për atë institucion.

Grupi i punës, konstatoi se, nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit, në momentin e hartimit dhe miratimit të planit të nevojave për rekrutim në pozicionet e shërbimit civil, për vitet kur ky akt është miratuar viti 2021 dhe 2022, nuk është përcaktuar numri i pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, si dhe të nivelit të lartë drejtues, të cilat do të plotësohen me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, duke mos respektuar kërkesën ligjore, që të mos kapërcehet kufiri i lejuar për institucionin.

Pra, gjatë periudhës **shtator 2019 – mars 2022**, nga këqyrja e dosjeve të konkurrimit për punonjësit të cilët aktualisht janë të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, konstatohet se, janë realizuar 105 procedura konkurrimi, janë shpallur dhe plotësuar pozicionet e ndara sipas kategorive të nëpunësisë, ndër vite, të paraqitura në tabelën nr. 3.

Tabela nr. 3 Pozicionet të shërbimit civil, të plotësuara gjatë periudhës shtator 2019 - mars 2022

Pozicionet e ndara sipas kategorive	Numri i pozicioneve të plotësuara çdo vit				Totali numri i pozicioneve të plotësuara sipas kategorive
	2019	2020	2021	2022	
<i>Kategoria e nivelit të lartë drejtues</i>	1	-	-	-	<b>1</b>
<i>Kategoria e nivelit të mesëm drejtues</i>	1	4	2	6	<b>13</b>
<i>Kategoria e nivelit të ulët drejtues</i>	2	11	2	7	<b>22</b>
<i>Kategoria ekzekutive</i>	8	27	21	13	<b>69</b>
<b>Totali numri i pozicione të plotësuara çdo vit</b>	<b>12</b>	<b>42</b>	<b>25</b>	<b>26</b>	<b>105</b>

**Konkluzion:** Në lidhje me sa më sipër, konstatohet se, njësia përgjegjëse nuk ka respektuar detyrimin ligjor për përgatitjen e planit të nevojave për rekrutim për vitin 2019 dhe 2020, në institucionin Bashkia Kamëz, në përputhje me përcaktimet e nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

Edhe në rastet e krijimit rishtazi të pozicioneve të pa planifikuara në planin vjetor të rekrutimit për vitet 2021 dhe 2022, si rrjedhojë e dorëheqjes, kalimit në një pozicion tjetër pune të punonjësit apo lirimit nga shërbimi civil, sipas shkaqeve të parashikuara në ligj, njësia përgjegjëse e institucionit, duhet të merrte masa për reflektimin e vakancës nëpërmjet ndryshimit të planit vjetor sipas kërkesave të akteve përkatëse nënligjore.

Gjithashtu, konstatohet se, plani i pranimit në shërbimin civil i miratuar për vitet 2021 dhe 2022, nuk është publikuar në faqen e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), në faqen zyrtare, apo në stendën e informacionit të Bashkisë Kamëz, në respektim të pikës 13, të VKM-së nr. 108, datë 26.02.2014, e cila parashikon se: “Njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura publikojnë vendimet për miratimin e planeve vjetore të punësimit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqet e tyre zyrtare dhe në stendat për njoftime publike të institucionit”.

Për më tepër, njësia përgjegjëse e institucionit, në momentin që harton dhe miraton planin e nevojave për rekrutim në pozicionet e shërbimit civil, për vitin respektiv, duhet të

përcaktojë edhe numrin e pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, si dhe të nivelit të lartë drejtues, të cilat do të plotësohen me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, duke respektuar që të mos kalojë kufijtë ligjor numerik të lejuar, ç'ka në këtë rast nuk është respektuar si një detyrim ligjor.

**2. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues nëpërmjet konkurrimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 22, 25, 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në lidhje me dy fazat e këtij procesi**

Bazuar në Kreun IV dhe V, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pozicionet e lira pjesë e shërbimit civil, plotësohen vetëm nëpërmjet procedurave të konkurrimit.

Për sa më sipër, grupi i punës verifikoi emërimet në pozicionet e shërbimit civil nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë të kryera për punonjësit të cilët janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, deri në momentin e mbikëqyrjes.

Gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit (shtator 2019 – mars 2022), vërehet se, nga njësia përgjegjëse në disa raste nuk është përmbushur detyrimi për të publikuar:

- aktin e shpalljes së konkurrimit;
- aktin e verifikimit paraprak e përfundimtar dhe;
- publikimi i listës përfundimtare të kandidatëve fitues,

i cili është kusht procedural që përcaktohet në dispozitat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”; Vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Respektimi i kësaj procedure është një tregues real i transparencës së konkurrimeve, pasi i krijon mundësinë kandidatëve apo çdo shtetasi të interesuar, të njihet me shpalljen për një pozicion vakant në administratën publike, të njihet me kandidatët që do marrin pjesë në konkurrim dhe të njihet me fituesit në këtë proces. Gjithashtu, respektimi i kësaj procedure

garanton zbatimin e parimeve të shanseve të barabarta dhe transparencës, të përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga këqyrja e dokumentacionit të hartuar në të gjitha konkurrimet e realizuara në institucionin e Bashkisë Kamëz, u vërejt se, njësia përgjegjëse e institucionit ka vepruar si më poshtë:

- ✓ Në disa raste nuk ka bërë publike në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), në rubrikën “*vende vakante*”, njoftimin për shpalljen e vendeve të lira i cili duhet të ketë të pasqyruar në përmbajtje të gjithë informacionin e parashikuar nga legjislacioni specifik që rregullon këtë aspekt.

Nga kontrolli i faqes zyrtare të AKPA-së, rezulton se, për periudhën 16 nëntor 2020 deri maj 2022, (*publikimi i parë në faqen zyrtare të AKPA, mbajnë datën e 16 nëntor*), janë publikuar vetëm këto pozicione:

- Pozicionet e publikuara për vitin 2020 janë **6 pozicione**, të ndara sipas kategorive të nëpunësisë civile:
  - Niveli mesëm drejtues **2** pozicione;
  - Niveli i ulët drejtues **1** pozicion;
  - Niveli ekzekutiv **3** pozicione.
- Për vitin 2021 janë publikuar **25 pozicione** pune, pranë Bashkisë Kamëz, të ndara në kategoritë si më poshtë vijon:
  - Niveli mesëm drejtues **7** pozicione;
  - Niveli i ulët drejtues **3** pozicione;
  - Niveli ekzekutiv **15** pozicione
- Bashkia Kamëz për vitin 2022 ka publikuar pranë AKPA, **26 pozicione** pune, të ndara, **9** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **17** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Ndërkohë, u konstatua se në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz, në rubrikën “*vende vakante*”, janë publikuar disa nga pozicionet e lira të shpallura për tu plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrimit, por nuk evidentohet data e publikimit të njoftimeve sipas fazave të konkurrimit, si dhe nuk ka një lidhje kronologjike të publikimit të parë të shpalljes për pozicionin e lirë dhe publikimeve për atë pozicion pune gjatë fazave të konkurrimit në vijim.

- ✓ Në përfundim të fazës së verifikimit paraprak, në të gjitha rastet njësia përgjegjëse nuk ka bërë publike në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në rubrikën “*vende vakante*”, listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret, në përputhje me legjislacionin specifik që rregullon këtë aspekt.
- ✓ Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve nga komisionet përkatëse, në të gjitha rastet njësia përgjegjëse nuk ka bërë publike në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në rubrikën “*vende vakante*”, listën e kandidatëve fitues (*listën e kandidatëve fitues në përfundim të konkurrimit dhe listën përfundimtare të kandidatëve fitues, mbas ankesës në rastin kur kishte të tillë*), në përputhje me legjislacionin specifik që rregullon këtë aspekt.

Për një analizë sa më të plotë të procesit të konkurrimeve, ato i grupojmë në procedura që materializojnë:

- a) Lëvizjen paralele dhe pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive;
- b) Ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil për nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues;
- c) Ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil për nivelin e lartë drejtues.

**a) Lëvizja paralele dhe pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive**

Në nenet 22, 23 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, përcaktohen rregullat procedurale të konkurrimit, për plotësimin e pozicioneve të punës në nivelin ekzekutiv.

Sipas dispozitave të mësipërme ligjore, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, bëhet së pari, nga nëpunësit civil të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele. Nëse pozicionet e lira në një procedurë konkurrimi në kategorinë ekzekutive plotësohen me anën e procedurës së lëvizjes paralele, njësia përgjegjëse e institucionit shpall të mbyllur këtë fazë të konkurrimit, duke bërë edhe njoftimin përkatës. Ndërsa, në rast se, mbeten pozicione të lira pas aplikimit të procedurës së lëvizjes paralele, atëherë njësia përgjegjëse vijon fazën tjetër të konkurrimit për plotësimin nëpërmjet pranimit në kategorinë ekzekutive.

Në zbatim të dispozitave ligjore si më sipër, njësia përgjegjëse e institucionit Bashkia Kamëz, për periudhën shtator 2019 - mars 2022, për plotësimin e pozicioneve të lira në nivelin ekzekutiv ka realizuar **69 procedura konkurrimi**, nëpërmjet pranimit në kategorinë ekzekutive. Nga analiza e të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të

mbikëqyrjes si dhe akt konstatimeve të mbajtura për secilën procedurë konkurrimi, rezulton se, në 26 raste procedurat e konkurrimit nuk janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e nenit 22, 23 dhe 24 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar, të cilat, të ndara sipas viteve janë paraqitur në tabelën më poshtë:

*Tabela nr. 4 Procedura për pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, ku janë evidentuar edhe procedurat e konstatuara në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil*

<b>Procedura konkurrimi për pranimin në kategorinë ekzekutive, të ndara sipas viteve</b>					
	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>Total</b>
<b>Procedura konkurrimi të vlefshme</b>	2	15	13	13	<b>43</b>
<b>Procedura konkurrimi të pavlefshme</b>	6	12	8	0	<b>26</b>
<b>Total, procedura konkurrimi të kryera</b>	<b>8</b>	<b>27</b>	<b>21</b>	<b>13</b>	<b>69</b>

➤ **Problematika të konstatuara gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit për pranimin në kategorinë ekzekutive**

Gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit në nivelin ekzekutiv janë konstatuar këto parregullsi:

- ✓ Në shumicën e procedurave të konkurrimit, njësia përgjegjëse nuk ka bërë shpalljen e procedurës së pranimi në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, si dhe në *Faqen Zyrtare*, të Bashkisë Kamëz, për të përcaktuar pozicionet e lira të punës, për të cilat do të zhvillohet konkurrimi, në përputhje me kërkesat e pikës 6, 7 dhe 8, të Kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar;

Duke qenë pjesë e përmbajtjes së shpalljes për pozicionin e lirë, rezulton se, nuk janë bërë publike gjithashtu edhe përshkrimi përgjithësues i pozicionit të punës; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimi në shërbimin civil (*arsimi i*



*lartë përkatës*); dokumentacioni që do të paraqitet; data për paraqitjen e aplikimit; data e zhvillimit të konkurrimit; data për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyra e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim, ç'ka është detyrim i parashikuar në pikën 9, të Kreut II, të këtij akti nënligjor.

Publikimi i shpalljes për pozicionin e lirë të punës në faqen e AKPA-së, është një garanci ligjore për ti dhënë të drejtën dhe mundësinë të gjithë kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të posaçme për pozicionin e shpallur, të marrin pjesë në fazën e konkurrimit për pozicionin, duke garantuar në këtë mënyrë repektimin e parimeve të shërbimit civil, të shanseve të barabarta; meritës; aftësive profesionale e mosdiskriminimit; si dhe kryejës së procedurës së konkurrimit nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë, (neni 20, i ligjit nr.152/2013, i ndryshuar).

Mospublikimi i shpalljes së pozicionit të punës, si dhe mosrespektimi i afateve të publikimit, sjell gjithashtu shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, për të marrë pjesë në procedurat e konkurrimit dhe për tu shpallur fitues në përfundim të tyre, duke kufizuar në këtë mënyrë edhe të drejtën kushtetuese “*E drejta e punësimit*”. Si rrjedhim, mungesa e publikimit të pozicionit të lirë, e bën procedurën e konkurrimit të pavlefshme.

- ✓ Me urdhër të titullarit të institucionit (për vitet respektive kur është zhvilluar procedura e konkurrimit), është krijuar *Komiteti i Përhershëm i Pranimi në Kategorinë Ekzekutive, KPP*, me përbërje të njëjtë, pavarësisht fushës së konkurrimit dhe pozicioneve që do të plotësohen.

Në të gjitha rastet ky organ ka në përbërjen e vet 3 përfaqësues të institucionit dhe 2 ekspertë të jashtëm, të cilët në këtë rast, janë të njëjtët për të gjitha konkurrimet e zhvilluara ndër vite dhe nuk janë ndryshuar në varësi të fushës së vlerësimit për grupet përkatëse, duke mosrespektuar në këtë mënyrë kërkesat e pikës 3, të Kreut III, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar. Gjithashtu, konstatohet se, në përbërje të KPP-së, si anëtar në secilin komitet ka qenë edhe një punonjës me funksion politik, bëhet fjalë për pozicionin “*Zv/Kryetar Bashkie*”, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së, e cila sanksionon se KPP, përbëhet nga:

- a) 1 (një) anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson KPP-në;
- b) Për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, 2 (dy) anëtarë të zgjedhur nga titullari midis nëpunësve të institucionit, nëse është e mundur të nivelit të mesëm drejtues;

*c) 2 (dy) ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit për grupet përkatëse.*

- ✓ Gjatë procedurës së verifikimit paraprak të ndjekur nga njësia përgjegjëse, nuk janë respektuar përcaktimet e pikës 2, 3, 4, 5 dhe 6, të Kreut IV, të VKM-së nr.243, datë 18.03.2015, i ndryshuar, lista me kandidatët e kualifikuar nuk është shpallur në portalin “AKPA”-së, si dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz, apo në rastet kur është publikuar tek kjo e fundit, shpallja nuk ka datë që të dokumentohet afati i publikimit. Gjithashtu, pranimi i dokumentacionit dhe verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, lëvizjes paralele dhe pranimin në shërbimin civil, janë kryer në të shumtën e rasteve brenda ditës, duke mos respektuar afatet e ankimit për kandidatët e s’kualifikuar.
- ✓ Në disa raste, kandidatët e kualifikuar, i janë nënshtruar testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, por rezulton që gjatë zhvillimit të procedurave të konkurimit të sipërcituara, procedura e testimit nuk është dokumentuar me aktet përkatëse, në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë këtë aspekt. Konkretisht, në dosjet e konkurrimit në disa procedura konkurimi aktet e hartuara gjatë procedurës nuk janë firmosur nga anëtarët e KPP dhe/apo kandidati pjesëmarrës, *(si për rastin e \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\*; dokumentacioni i hartuar gjatë procedurës së konkurrimit nuk është i firmosur);* mungon dokumentacioni provues i kryerjes së fazave të testimit, *(si për rastin e \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\* nuk gjendet asnjë dokument që provon zhvillimin e procedurës së konkurrimit);* ose në dosjen e konkurrimit gjendet vetëm testi me shkrim i kandidatit, i pa vlerësuar nga KPP, për të vërtetuar se ka kaluar pragun e 30 pikëve, ndërsa për fazën e testimit me gojë nuk ka asnjë akt provues, *(si për rastin e \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\*; në dosje gjendet vetëm testi i provimit me shkrim, i pa vlerësuar).*
- ✓ Gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit, (testimit me shkrim dhe me gojë), KPP, në shumicën e rasteve nuk ka hartuar tezat e pyetjeve me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, e për pasojë mungon edhe çelsi i përgjigjeve, në të dy rastet. Gjithashtu, procedura e vlerësimit të kandidatit në fazat e konkurrimit nuk është dokumentuar me anë të procesverbaleve që duhet të hartoheshin për këtë qëllim nga KPP. Për të përfunduar procesin, Komiteti i Përhershëm i Pranimin, ka hartuar një procesverbal të përbashkët për vlerësimin me pikë të kandidatëve, për të tre fazat e konkurrimit, dhe i ka renditur kandidatët fitues në një listë, duke filluar nga kandidati me rezultatin më të lartë *(më shumë se 70 pikë).*
- ✓ Lista e fituesve, në të gjitha rastet nuk është publikuar në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në Faqen Zyrtare të Bashkisë Kamëz.

Akti i emërimit i kandidatit fitues është nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë në të gjitha rastet. Njësia përgjegjëse nuk ka deklaruar statusin e kandidatit fitues *si nëpunës civil në periudhë prove* në pozicionet përkatëse.

- ✓ Për më tepër, të gjitha aktet e nxjerra gjatë procedurës së konkurrimit, deri në momentin e hartimit të raportit të vlerësimit të kandidatit, të hartuara nga KPP, janë nxjerrë nga Bashkia Kamëz, të pa firmosura nga njësia përgjegjëse, në kundërshtim me përcaktimet e Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017, të Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e rregullores së njëhësuar të punës me dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë*”.

Në vijim të analizës së procedurave të konkurrimit, rezulton se, njësia përgjegjëse e institucionit, për pozicionet e nivelit ekzekutiv ka zhvilluar konkurrime individuale, si dhe numri i kandidatëve që kanë aplikuar në shumicën e konkurrimeve ka qenë 1 (një).

Nga publikimi i akteve në përfundim të procedurës së konkurrimit, rezulton se njësia përgjegjëse, nuk ka të dokumentuar trajtimin e asnjë rasti ankimi, në procedurat e konkurrimit ku ka patur më tepër se një kandidat të kualifikuar për fazën e testimit. Bëhet fjalë për procedurat e pranimit për pozicionin “*Specialist i Sektorit të Projekteve dhe Integritit të BE dhe Projekteve të Huaja*”, të kualifikuar për testimin me shkrim 2 kandidatë; pozicioni “*Specialist i Ndihmës Ekonomike, Lagjia nr.2*”, të kualifikuar për testimin me shkrim 3 kandidatë; pozicioni “*Specialist Protokoll-Arkive*”, të kualifikuar 2 kandidatë; pozicioni “*Specialist i Sektorit të Rindërtimit*”, të kualifikuar 2 kandidatë.

Më tej, rezulton se nga ana e KPP, në të shumtën e rasteve nuk është hartuar teza e provimit me shkrim (*me shtjellim*) dhe teza e intervistës së strukturuar me gojë, e cila duhet të jetë brenda fushës së testimit të publikuar, si dhe bashkëlidhur duhet të shoqërohet me çelësin e përgjigjeve. Ky dokumentacion duhet të jetë i nënshkruar nga anëtarët e KPP-së, dhe rezulton se, në shumicën e procedurave të konkurrimit të zhvilluara për pranimin në shërbimin civil, anëtarët e KPP-së nuk i kanë nënshkruar këto akte, (dokumentuar në aktet e konstatimit për pranimin në shërbimin civil).

Më tej, në vazhdim të këqyrjes së akteve të shpalljes, konstatohet fakti se në disa raste, pozicioni i punës për të cilin është zhvilluar procedura e konkurrimit, ka pasur të njëjtën emërtesë, ka qenë pjesë e të njëjtës njësi organizative (*drejtori*) dhe ka pasur të njëjtat kriteret të posaçme, dhe në këtë rast, njësia përgjegjëse e institucionit ka vijuar procedurën e konkurrimit duke shpallur të 3 (tre) pozicionet e lira, në grup (**shpallja nr.07 prot., datë 25.01.2021**, “*Njoftim për vend të lirë pune*”, për pozicionin “*Specialist i Analizës dhe Kontabilizimit të Detyrimeve*”). Në vijim, procedura e konkurrimit është zhvilluar për të tre pozicionet e punës, ku gjatë verifikimit paraprak; kualifikimit të kandidatëve, kanë

rezultuar **3 kandidatë të kualifikuar**, si dhe nga Raporti i vlerësimit i hartuar nga KPP janë shpallur **3 fitues**.

Mirëpo, njësia përgjegjëse, sërisht të njëjtat pozicione pune “*Specialist i Analizës dhe Kontabilizimit të Detyrimeve*”, i ka rishpallur edhe dy herë të tjera, duke i dhënë shkresës “*Njoftim për shpallje*”, numra të rinj protokolli (**shpallja nr. 09 prot., datë 25.01.2021; shpallja nr. 08 prot., datë 25.01.2021**). Gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit sërisht për këto pozicione pune, janë kualifikuar të njëjtët kandidatë dhe fitues kanë rezultuar të njëjtët kandidatë (\*\*\*\*\*; \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\*).

Aktet e emërimit për secilin kandidat janë nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë, duke u protokolluar në varësi të numrit të shpalljes.

E njëjta problematikë, rishpallje e pozicioneve të punës me numra protokolli të ndryshëm, edhe pse me shpalljen e parë në fund të procedurës së konkurrimit kanë rezultuar dy fituese (\*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*), është konstatuar edhe për pozicionin “*Specialist, në Sektorin e Menaxhimit të Borxhit*”, shpallur me aktin nr. 19 prot., datë 20.01.2020 dhe aktin nr. 20 prot., datë 20.01.2020.

**Konkluzion:** Komisioneri, vlerëson se, në të gjitha procedurat e konkurrimit për pranimin në nivelin ekzekutiv të zhvilluara në subjektin e mbikëqyrur, Bashkia Kamëz janë konstatuar probleme të cilat u analizuan më sipër, por në disa raste këto konstatime përbëjnë parregullsi që nuk sjellin pavlefshmëri të procesit të konkurrimit, pasi nuk çenojnë parimet e legjislacionit të shërbimit civil dhe përmenden që të mbahen parasysht në të ardhmen dhe të mos përsëriten.

Ndërkohë, mungesa e akteve administrative dhe mosveprimi i subjekteve të ngarkuara me ligj për të kryer veprime të posaçme, që e klasifikojnë një procedurë konkurrimi si absolutisht të pavlefshme, siç janë:

- ✓ *Mungesa e shpalljes së procedurës së pranimi për secilin grup në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, në stendat e informimit të publikut, si dhe në faqen e internetit në Bashkinë Kamëz;*
- ✓ *Mungesa e ngritjes së Komitetit të Përherhshëm të Pranimi në shërbimin civil;*
- ✓ *Mungesa e akteve që dokumentojnë procedurën e konkurrimit, si teza e provimit me shkrim dhe testimi me gojë;*
- ✓ *Mungesa e Raportit të vlerësimit të kandidatëve, në përfundim të procedurës së konkurrimit, të hartuar nga KPP;*

- ✓ *Mosplotësimi i kriterit arsimor të kërkuar për pozicionin e punës të shpallur të lirë;*
- ✓ *Mungesa totale e procedurave të konkurrimit për emërimin në pozicione të shërbimit civil, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë aspekt të shërbimit civil, e për pasojë, emërimet të kundraligjshme nëpërmjet akteve të përkohshme të emërimit;*

të cilat janë dokumentuar në akt konstatimet e mbajtuara nga grupi i mbikëqyrjes, për secilin punonjës të emëruar në pozicione të kategorisë ekzekutive, janë konstatuar në 26 procedurat e konkurrimit të ndara sipas viteve, për punonjësit e identifikuar si më poshtë:

#### ❖ **Procedura konkurrimi absolutisht të pavlefshme të realizuara për vitin 2019**

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist i Sektorit e Infrastrukturës dhe Investimeve e Rrugëve*”, me aktin nr. 763, datë 20.12.2019, të Kryetarit të Bashkisë.
2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialiste e Koordinimit Zhvillimit të Projekteve dhe BE-së*”, me aktin nr. 761, datë 20.12.2019, të Kryetarit të Bashkisë.
3. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Drejtorinë Juridike, me aktin nr. 601, datë 25.10.2019, të Kryetarit të Bashkisë dhe aktualisht, me aktin nr.99, datë 01.02.2022, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Kadastrës*”, në kundërshtim me ligjin.
4. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Transportit, Lejeve dhe Licensimit*”, me aktin nr. 759, datë 20.12.2019, të Kryetarit të Bashkisë.
5. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist i Medias*”, me aktin nr. 590, datë 24.10.2019, të Kryetarit të Bashkisë.
6. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e MTPM-së*”, me aktin nr. 596, datë 25.10.2019, të Kryetarit të Bashkisë.

#### ❖ **Procedura konkurrimi absolutisht të pavlefshme të realizuara për vitin 2020**

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist Arkive*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, me aktin nr. 273, datë 01.07.2020, të Kryetarit të Bashkisë.
2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist Statistike*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, me aktin nr. 88, datë 12.02.2020, të Kryetarit të Bashkisë dhe aktualisht, me aktin nr. 502, datë 08.10.2020, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Statistikave*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në kundërshtim me ligjin.
3. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist pranë Sektorit të Statistikave*”, me aktin nr. 501, datë 08.10.2020, të Kryetarit të Bashkisë.

4. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist i Sektorit të Projektimit*”, me aktin nr. 96, datë 18.02.2020, të Kryetarit të Bashkisë dhe aktualisht, me aktin nr.319, datë 27.07.2020, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Projekteve dhe Investimeve*”, në kundërshtim me ligjin.
5. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist i Sektorit të Rindërtimit*”, në Drejtorinë e Projekteve dhe Investimeve, me aktin nr. 315, datë 22.07.2020, të Kryetarit të Bashkisë dhe aktualisht, me aktin nr. 263, datë 15.03.2022, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Drejtor*”, pranë Drejtorisë së Rindërtimit, në kundërshtim me ligjin.
6. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist i Sektorit të Projekteve dhe Integritit të BE*”, me aktin nr. 256, datë 22.06.2020, të Kryetarit të Bashkisë.
7. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist i Sektorit të Projekteve dhe Integritit të BE dhe Projekteve të Huaja*”, me aktin nr. 521, datë 15.10.2020, të Kryetarit të Bashkisë.
8. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist i Menaxhimit të Taksës Familjare*”, Drejtoria e Tatim Taksave Vendore, me aktin nr. 466, datë 24.09.2020, të Kryetarit të Bashkisë.
9. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist i Shërbimeve Publike*”, lagjja Bathore, me aktin nr. 313, datë 22.07.2020, të Kryetarit të Bashkisë dhe aktualisht, me aktin nr. 401, datë 02.09.2020, të Kryetarit, është emëruar në “*Specialiste e Ndhmës Ekonomike*”, lagjja Bathore, në kundërshtim me ligjin.
10. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*”, Lagjja nr. 1, me aktin nr. 251, datë 22.06.2020, të Kryetarit të Bashkisë dhe aktualisht, me aktin nr. 189, datë 24.02.2022, të Kryetarit, emërohet në pozicionin “*Përgjegjës*”, pranë Lagjes nr. 1, Bashkia Kamëz, në kundërshtim me ligjin.
11. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist*”, njësia administrative Paskuqan, me aktin nr. 133, datë 17.03.2020, të Kryetarit të Bashkisë.
12. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist Protokolli e Arkive*”, me aktin nr. 89, datë 12.02.2020, të Kryetarit të Bashkisë.

❖ **Procedura konkurrimi absolutisht të pavlefshme të realizuara për vitin 2021**

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist Protokolli*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, me aktin nr. 95, datë 19.02.2021, të Kryetarit të Bashkisë, pasi ky pozicion nuk është në shërbimin civil, prandaj duhet të rregullohet sipas së Drejtës së Punës.
2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*”, në Njësinë Administrative Paskuqan, me aktin nr. 133, datë 09.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë.
3. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist Statistike*”, në Drejtorinë e

- Burimeve Njerëzore, me aktin nr. 168, datë 19.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë.
4. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialiste Investimi dhe Monitorimi të Infrastrukturës*”, me aktin nr. 377, datë 13.07.2021, të Kryetarit të Bashkisë.
  5. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist i Sektorit të Rindërtimit*”, me aktin nr. 408, datë 06.08.2021, të Kryetarit të Bashkisë, pasi ky pozicion është i përkohshëm si funksion, prandaj duhet të rregullohet sipas së Drejtës së Punës.
  6. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist i Emergjencave Civile*”, me aktin nr. 489, datë 30.09.2021, të Kryetarit të Bashkisë.
  7. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist i personelit ndihmës parauniversitar*”, me aktin nr. 282, datë 25.05.2021, të Kryetarit të Bashkisë, pasi ky pozicion nuk është në shërbimin civil, prandaj duhet të rregullohet sipas së Drejtës së Punës.
  8. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Drejtorinë e Çështjeve Ligjor, me aktin nr. 281, datë 26.05.2021, të Kryetarit të Bashkisë dhe aktualisht, me aktin nr. 265, datë 15.03.2022, të Kryetarit, kalon në pozicionin “*Drejtor*”, pranë Drejtorisë së Prokurimit Publik dhe IT, Bashkia Kamëz, në kundërshtim me ligjin.

#### ❖ Procedura konkurrimi të realizuara për vitin 2022

Për vitin 2022 janë realizuar **13** procedura konkurrimi për pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, në të cilat janë evidentuar disa nga problematikat e përmendura në këtë material, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit, por rezulton se ato nuk e çenojnë ligjshmërinë e procesit të konkurrimit, për ta kategorizuar si të pavlefshëm.

Në të gjitha procedurat e pranimit në kategorinë ekzekutive të pasqyruara më lart, rezulton se, nga **69** procedura konkurrimi, në **26** raste, procedurat e zhvilluara për pranimin në kategorinë ekzekutive janë kryer në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil. Aktet e emërimit për **26** punonjësit e kategorisë ekzekutive, të ndarë sipas viteve, të pasqyruara sa më lart, janë nxjerrë duke mos respektuar procedurat e domosdoshme administrative për rekrutimin në shërbimin civil, të sanksionuara në nenet 22, 23, 24 dhe 25, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në Kreun II, të Vendimit të Këshillit të Ministave nr. 234, datë 18.03.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar.

Gjithashtu, kjo gjendje paligjshmërie ka vijuar më tej, duke kualifikuar disa prej këtyre punonjësve të cilët nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil, për të marrë pjesë në procedurat e ngritjes në detyrë, për pozicionin “*Përgjegjës Sektori*” dhe/ose “*Drejtor Drejtorie*”, ndërkohë që nuk zotëronin statusin e nëpunësit civil në një kategori më të ulët të nëpunësisë civile.

**Konkluzion:** Aktet e emërimit për 26 punonjësit e kategorisë ekzekutive, të pasqyruara sa më lart, janë nxjerrë duke mos respektuar procedurat administrative për rekrutimin në shërbimin civil, të sanksionuara në nenet 22, 23, 24 dhe 25, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në Kreun II, të Vendimit të Këshillit të Ministave nr. 234, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar.

- Njësia përgjegjëse, duhet të planifikojë ecurinë e procedurës së anulimit të akteve të nxjerra në kundërshtim me ligjin, me qëllim që konstatimi si akte absolutisht të pavlefshëm prej Kryetarit të Bashkisë, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke e ndarë procesin e rregullimit të ligjshmërisë.
- Njësia përgjegjëse duhet të hartojë për vitin 2023, planin e punës së pranimeve në shërbimin civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira pas ekzekutimit të këtij vendimi, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke mbajtur parasysht orientimet, në pikat më sipër të këtij vendimi.

❖ Ndërsa sa i takon pozicioneve të punës:

- ✓ “Specialist i Shërbimeve Publike”, lagjja Bathore;
- ✓ “Specialist i Ndihmës Ekonomike”, lagjja nr. 1;
- ✓ “Specialist Jurist”, njësia administrative Paskuqan, (pasi mund të përfshihet në njësinë bazë në bashki);
- ✓ “Specialist Protokollit”, Bashkia Kamëz;
- ✓ “Specialist i Ndihmës Ekonomike”, njësia administrative Paskuqan;
- ✓ “Specialist i Sektorit të Rindërtimit”, Bashkia Kamëz, (pasi është i përkohshëm si funksion);
- ✓ “Specialist në Drejtorinë e Liçensave dhe Transportit”, Bashkia Kamëz;
- ✓ “Specialiste Statistike dhe Sekretare e Kryetarit”, Bashkia Kamëz, (të ndahet pozicioni i shërbimit civil nga funksioni politik),

njësia e burimeve njerëzore të institucionit duhet të saktësojë emërtesat e pozicionit të punës, ku të përcaktohen qartë detyrat teknike dhe përgjegjësitë ligjore që realizon, secili prej tyre në përputhje me kërkesat e akteve nënligjore: Vendimi nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, ...institucionet në varësi të ministrive të linjës.....”, të Këshillit të Ministrave, si dhe Vendimi nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës



*shtetërore dhe institucionet e pavarura”.*

- Gjatë realizimit të procedurave për përgatitjen dhe propozimin e strukturës së re organizative të bashkisë, duhet të vlerësohen me përgjegjësi tiparet e çdo pozicioni pune, në raport me shërbimin civil. Nëse vlerësohet se, pozicioni ka tiparet e shërbimit civil, atëherë ai duhet të trajtohet si pozicion i shërbimit civil, në të kundërt duhet të ndryshojë regjimi juridik i rregullimit të marrëdhënies së punësimit, duke respektuar procedurën e parashikuar në ligj.

***Problematikat e evidentuara në secilin rast janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar, për secilin punonjës, në rubrikën “shënime”, të Aneksit nr. 1, pjesë përbërëse e projekt raportit të mbikëqyrjes.***

***b) Lëvizja paralele, ngritja në detyrë dhe pranimi nga jashtë shërbimit civil, për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues***

Rregullat procedurale të konkurrimit për të plotësuar pozicionet e punës në kategorinë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, (*lëvizja paralele, ngritja në detyrë dhe pranimi nga jashtë shërbimit civil*), janë të parashikuara në nenet 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”.

Sipas përcaktimeve të mësipërme ligjore, edhe për këtë procedurë, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari, nga nëpunësit civil të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, e nëse me anën e kësaj procedure pozicionet e lira nuk plotësohen, atëherë vijon procedura për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, me procedurën konkurruese ngritje në detyrë.

Përrjashtimisht, në pikën 4, të nenit 26, të Ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, ligjvënësi ka parashikuar një rast përjashtimor, sipas së cilit:

*“Përrjashtimisht, Këshilli i Ministrave, për institucionet e administratës shtetërore dhe organi kompetent për institucionet e pavarura mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira. Në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20 për qind të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.”*

Më tej, në zbatim të pikës 9, të nenit 26, të ligjit në fjalë, Këshilli i Ministrave me Vendimin e tij nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, ka miratuar kushtet dhe procedurën e hollësishme për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e nivelit të ulët apo të mesëm drejtues.

Konkretisht, në pikën 43, të Kreut III “Ngritja në detyrë”, të këtij vendimi përcaktohet se:

*“Në rast se një vend vakant në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe Këshilli i Ministrave për institucionet e administratës shtetërore apo organi kompetent për institucionet e pavarura, ka marrë vendim në përputhje me pikën 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, atëherë në procedurën e ngritjes në detyrë kanë të drejtë të konkurrojnë edhe kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil.”*

Referuar, dispozitave ligjore të sipërcituara rezulton se, në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këto kategori nuk mund të kalojë 20% të numrit total të pozicioneve të punës në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese për vitin kalendarik. Gjithashtu, referuar pikës 43, të Kreut III, të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, organi kompetent, duhet të planifikojë plotësimin e pozicioneve me pranim nga jashtë shërbimit civil, në momentin e hartimit të planit vjetor të rekrutimit.

**Konkluzion:** Konstatohet se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur Bashkia Kamëz, nuk janë respektuar dispozitat ligjore të parashikimit të pozicioneve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese për tu plotësuar përmes procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil, në momentin e hartimit të planit të rekrutimit, për vitin 2021 dhe vitin 2022, kur është hartuar dhe miratuar plani i rekrutimit nga titullari i bashkisë, ndërsa për vitet 2019 dhe 2020 nuk është miratuar plani i rekrutimit nga njësia përgjegjëse.

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se, për periudhën objekt mbikëqyrjeje, shtator 2019- mars 2022, nga njësia përgjegjëse e institucionit Bashkia Kamëz, janë realizuar 35 procedura konkurrimi për plotësimin e 35 pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, nga të cilat 15 procedura kanë përfunduar me ngritje në detyrë dhe 20 procedura me pranim nga jashtë shërbimit civil.

Tabela nr. 5 Plotësimi i pozicioneve në kategorinë e mesmë dhe të ulët drejtuese, sipas procedurës së konkurrimit ngritje në detyrë apo pranim nga jashtë

Kategoria e mesme drejtuese	13 pozicione	
	<i>Ngritje në detyrë</i>	<i>Pranim nga jashtë</i>
	6	7
Kategoria e ulët drejtuese	22 pozicione	
	<i>Ngritje në detyrë</i>	<i>Pranim nga jashtë</i>
	9	13
<b>Totali</b>	<b>15</b>	<b>20</b>

Gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, për këto pozicione, nga njësia përgjegjëse e institucionit, nuk janë përmbushur rregullat e përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, duke vepruar si më poshtë:

- ✓ Njësia përgjegjëse, nuk ka bërë shpalljen e procedurës për vendet vakante, fillimisht nëpërmjet lëvizjes paralele dhe më pas, nëpërmjet ngritjes në detyrë/ pranimin në shërbimin civil, në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, si dhe në *Faqen Zyrtare*, të Bashkisë Kamëz, duke përcaktuar pozicionet e lira të punës, për të cilin do të zhvillohet konkurrimi; përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës, si dhe kushtet dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojë kandidati për ngritjen në detyrë, (pika 6, e Kreut II, të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar);
- ✓ Njësia përgjegjëse ka krijuar *Komitetin e Pranimin për Ngritjen në Detyrë*, për vitet 2019, 2020, 2021, (*Urdhër nr. 517, datë 24.09.2019*); (*Urdhër nr. 3859, datë 29.05.2020*); (*Urdhër nr. 165, datë 08.01.2021*), ndërsa për vitin 2022 mungon urdhri për ngritjen e KPND-së. Rezulton se gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit për ngritjen në detyrë dhe pranimin nga jashtë shërbimit civil për kategorinë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, komiteti pjesëmarrës në këto procedura ka qenë Komiteti i Përhershëm i Pranimin, i cili është ngritur për zhvillimin e procedurave të pranimin në kategorinë ekzekutive. Ky veprim vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe pikës 7, të Kreut III, “Ngritja në detyrë”, të Vendimit të Këshillit

- të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtues”, i ndryshuar, i cili sanksionon se:  
 “Vlerësimi i kandidatëve për ngritjen në detyrë realizohet nga Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND), i cili ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:
- a) 1 (një) anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson komitetin;
  - b) Për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, 1 (një) anëtar i zgjedhur nga titullari midis nëpunësve civilë të institucionit, nëse është e mundur të nivelit të mesëm drejtues;
  - c) Eprorin direkt të pozicionit, për të cilin zhvillohet konkurrimi;
  - ç) 2 (dy) ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit.”
- ✓ Pas verifikimit paraprak nga njësia përgjegjëse, lista me kandidatët e kualifikuar në asnjë rast nuk është shpallur në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, si dhe në Faqen Zyrtare të Bashkisë Kamëz;
  - ✓ Konstatohet se, nga ana e njësisë përgjegjëse, në disa raste janë kualifikuar kandidatë për fazën e konkurrimit “ngritje në detyrë”, punonjës të cilët nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil, të kategorisë së mëparshme;
  - ✓ Kandidatët e kualifikuar, që i janë nënshtruar testimit, në disa raste procedura e ndjekur gjatë fazës së testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, nuk është shoqëruar me hartimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor. Në përfundim të vlerësimit, Komiteti i Përherhshëm i Pranimit ka nxjerr aktin e kandidatit fitues, i cili, nuk është shpallur nga njësia përgjegjëse në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe më pas, është nxjerrë akti i emërimit, në pozicionin përkatës nga titullari i institucionit.

Evidentimi i këtyre problemeve në procedurat e konkurrimit të realizuara nga njësia përgjegjëse, për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, janë konstatuar gjatë zhvillimit të procedurave në të dy fazat e konkurrimit për këtë nivel, atë të “ngritjes në detyrë”, si dhe në fazën e “pranimit nga jashtë shërbimit civil”. Më konkretisht:

- Procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, të plotësuara përmes ngritjes në detyrë

Njësia përgjegjëse e institucionit të mbikëqyrur ka realizuar **15** procedura konkurrimi me ngritje në detyrë, të ndara në **6** pozicione të kategorisë së nivelit të mesëm drejtues dhe **9** pozicione të nivelit të ulët drejtues, për plotësimin e pozicioneve që rezultojnë të lira.

Në përfundim të procedurave të konkurrimit, për ngritjen në detyrë, rezultuan se janë kryer në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, vetëm 2 të tilla, bëhet fjalë për procedurat e konkurrimit për pozicionet:

- ✓ “Përgjegjës i Sektorit Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, në të cilën ka rezultuar fituese punonjësja \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 198, datë 24.02.2022, të Kryetarit;
- ✓ “Përgjegjës i Buxhetit dhe Financës”, në të cilën ka rezultuar fituese punonjësja \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 100, datë 01.02.2022, të Kryetarit.

Ndërsa, për **13** procedura konkurrimi, sipas problematikës së konstatuar, nga këqyrja e dokumentacionit të administruar në dosjen e konkurrimit për secilën prej tyre, u vërejt se, në **9** procedura konkurrimi, nga ana e njësisë përgjegjëse, për fazën e verifikimit paraprak janë kualifikuar për vijimin e procedurave të konkurrimit “*për ngritjen në detyrë*”, për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, punonjës pranë Bashkisë Kamëz, të cilët nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil, duke qenë se procedurat e pranimit në shërbimin civil për këta punonjës, u konstatuan si absolutisht të pavlefshme, ashtu si u evidentuan më sipër tek rubrika “*procedura konkurrimi absolutisht të pavlefshme*”, pjesë e këtij materiali.

Ndërsa, për **4** procedurat e konkurrimit, që do të evidentohen në vijim, gjatë administrimit të materialeve të konkurimit, nga grupi i punës, për secilën prej tyre u konstatuan këto probleme, sipas pozicioneve përkatëse:

1. Pozicioni “*Drejtor i Strehimit dhe Emergjencave Civile*”, me urdhrin nr. 374, datë 14.08.2020, “*Për ngritjen në detyrë*”, të Kryetarit, është emëruar \*\*\*\*\*.

Për këtë procedurë konkurrimi konstatohet se:

- ✓ Kandidatja, me urdhrin nr. 761, datë 20.12.2019, të Kryetarit, është emëruar “*Specialiste e Koordinimit, Zhvillimit të Projekteve të BE*”, procedurë e pavlefshme konkurrimi, pasi nuk është shpallur në portalin AKPA;
- ✓ Ndërkohë që i është deklaruar statusi si nëpunës civil me aktin nr. 1049 datë 24.03.2017, të njësisë përgjegjëse, Bashkia Bulqizë, në pozicionin “*Drejtor i Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve*” ;
- ✓ Me njoftim për shpallje me nr. 16 prot., datë 20.01.2020, “*Kërkesë për shpallje pozicione të lira pune*”, është planifikuar procedura e konkurrimit për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Strehimit*”, përmes lëvizje paralele/ngritje në detyrë, nuk provohet publikimi pranë AKPA-së;
- ✓ Me njoftimin për shpallje me nr. 71 prot., datë 17.07.2020, “*Kërkesë për shpallje pozicione të lira pune*”, është planifikuar procedura e konkurrimit për pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Strehimit dhe Emergjencave Civile*”, nuk provohet publikimi pranë AKPA-së;

- ✓ KPND nuk është ngritur në përputhje me kërkesat e pikës 7, të Kreut III, “Ngritja në detyrë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar, për dy procedurat e konkurrimit;
- ✓ Fazat e konkurrimit nuk dokumentohen me aktet administrative të kërkuara për të dy procedurat e konkurrimit.

**Konkluzion:** Punonjësja duke konkurruar për pozicionin “*Specialiste e Koordinimit, Zhvillimit të Projekteve të BE*”, pozicion i kategorisë ekzekutive, ka hequr dorë nga statusi i punësimit në kategorinë e mesme drejtuese, në pozicionin “*Drejtor i Arsimit, Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve*”, pranë Bashkisë Bulqizë. Nga këqyrja e akteve të procedurave të konkurrimit, të zhvilluara për plotësimin e pozicionit ekzekutiv “*Specialist*”, pozicionit të nivelit të ulët “*Përgjegjës Sektori*”, si dhe pozicionit të nivelit të mesëm drejtues “*Drejtor drejtorie*”, të administruara në dosjen e konkurrimit, të përmendura më lartë, në përfundim të së cilave ka rezultuar fituese \*\*\*\*\*. konstatohet se, këto procedura konkurrimi nuk kanë respektuar kërkesat ligjore dhe nënligjore që normojnë këtë institut të shërbimit civil, si rrjedhim aktet e emërimit në këto pozicione pune janë nxjerr në kundërshtim me kërkesat e neneve 22, 23 dhe 26, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar.

Në këto kushte, të gjitha aktet e emërimit të punësimit të nxjerra për punonjësën \*\*\*\*\*. të cituara si më lart, duhet të shpallen absolutisht të pavlefshme nga ana e vetë organit, që e ka nxjerr aktin respektiv, në mbështetje të nenit 108, “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”. Pozicioni i punës “*Drejtor në Drejtorinë e Strehimit dhe Emergjencave Civile*” duhet të rishpallet për tu plotësuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit shërbimit civil.

2. Pozicioni “*Përgjegjës i Financës dhe Kontabilitetit*”, në Bashkinë Kamëz, me urdhrin nr. 61, datë 03.02.2020, “*Për emërimin në detyrë*”, të Kryetarit të Bashkisë, është plotësuar nga punonjësja \*\*\*\*\*.

Për këtë procedurë konkurrimi konstatohet se:

- ✓ Me aktin nr. 9 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit si nëpunës civil, në pozicionin “*Specialist i Financës*”;
- ✓ Me njoftimin për shpallje, me nr. 01 prot., datë 06.01.2020, është planifikuar procedura e konkurrimit për pozicionin “*Përgjegjës i Financës dhe Kontabilitetit*”, nuk provohet publikimi pranë AKPA-së;

- ✓ Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND), është krijuar për këtë procedurë konkurrimi me Urdhrin nr. 517, datë 24.09.2019, ndërkohë procedura është zhvilluar në vitin 2020;
- ✓ Fazat e konkurrimit nuk dokumentohen me aktet administrative të kërkuara;

**Konkluzion:** Duke qenë se, procedura e konkurrimit për pozicionin “Përgjegjës i Financës dhe Kontabilitet” nuk është kryer në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore të shërbimit civil, që normojnë institutin e rekrutimit, punonjësja \*\*\*\*\*, duhet të kalojë në pozicionin e punës ku i është deklaruar statusi i punësimit, si “*Specialist i Financës*”. Pozicioni “Përgjegjës i Financës dhe Kontabilitetit” duhet të rishpallet dhe të plotësohet sipas ligjit.

3. Pozicioni “Përgjegjës”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, me urdhrin nr. 70, datë 08.02.2021, “Për ngritjen në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është plotësuar nga punonjësja \*\*\*\*\*.

Për këtë procedurë konkurrimi konstatohet se:

- ✓ Me aktin nr. 5185 prot., datë 11.10.2017, “Për deklarin e statusit të punësimit” është konfirmuar nëpunëse civile, punonjësja Armanda Prendi, në pozicion “*Specialiste Protokoll/Arkive*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në këtë Bashki;
- ✓ Kandidatja, me urdhrin nr. 53, datë 03.02.2020, “Për lëvizje paralele në detyrë”, të Njësisë së Burimeve Njerëzore, është emëruar në pozicionin “*Specialist i Burimeve Njerëzore*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore;
- ✓ Me njoftimin për shpallje, me nr. 02 prot., datë 15.01.2021, “Njoftim për vend të lirë pune”, është planifikuar procedura e konkurrimit për pozicionin “Përgjegjës i Burimeve Njerëzore”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, përmes procedurës së lëvizjes paralele/ngritjes në detyrë, por nuk është publikuar pozicioni pranë AKPA-së;
- ✓ Me Urdhrin nr. 165, datë 08.01.2021, (nr. 165 prot., datë 08.01.2021), “Për ngritjen e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë” është ngritur KPND;
- ✓ Kandidati i kualifikuar nuk plotëson kriterin e posaçëm arsimor, zotëron Master Profesional, në “*Administrim Biznes*”, ndërkohë që kërkesa është Master Shkencor.

**Konkluzion:** Njësia përgjegjëse duhet të verifikojë fillimisht, nëse punonjësja ka përfunduar studimet “*Master Shkencor*” ose “*Master Profesional*” me 120 kredite, për të qëndruar në pozicionin ku Aktualisht, është e emëruar si “Përgjegjës”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në të kundërt duhet të kalojë në pozicionin “*Specialiste e Burimeve Njerëzore*”, në përputhje me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministave nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve

të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar dhe pozicioni të rishpallet për tu plotësuar sipas ligjit.

4. Pozicioni “Drejtor i Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Sociale”, në Bashkinë Kamëz, me urdhrin nr. 264, datë 15.03.2022, “Për emërimin në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është plotësuar nga punonjësja \*\*\*\*\*.

Për këtë procedurë konkurrimi konstatohet se:

- ✓ Me urdhrin nr. 112, datë 26.02.2020, “Për emërimin në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë, është emëruar në pozicionin “Specialiste finance-kontabiliteti”, në Bashkinë Kamëz;
- ✓ Me aktin nr. 9393 prot., datë 06.10.2021, konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin, “Specialiste finance-kontabiliteti”. Ka kryer trajnimin në ASPA;
- ✓ Me shkresën nr. 1698 prot., datë 24.02.2022, “Kërkesë për shpallje pozicioneve të lira pune”, dërguar AKPA-së, është planifikuar procedura e konkurrimit për pozicionin “Drejtor i Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Sociale”.

**Konkluzion:** Kandidatja \*\*\*\*\* nuk duhej të kualifikohej për të vijuar procedurën e ngritjes në detyrë, pasi nuk gëzonte statusin e nëpunësit civil, të një kategorie paraardhëse, për të marrë pjesë në procedurën e ngritjes në detyrë, në përputhje me kërkesat e germës b), të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si rrjedhim duhet të kalojë në pozicionin ku i është deklaruar statusi si nëpunës civil, në pozicionin si “Specialiste finance-kontabiliteti”. Pozicioni i drejtorit duhet të rishpallet dhe të plotësohet sipas ligjit.

➤ Procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, përmes pranimit nga jashtë shërbimit civil

Në nenin 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përcaktohet se, organi kompetent, për institucionet e pavarura, mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil, me kusht që ata të plotësojnë kriteret dhe kërkesat për vendin/vendet e lira.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, për periudhën objekt mbikëqyrjeje, rezulton se këtë dispozitë ligjore, ashtu siç e kemi përmendur më sipër në material, (hartimi i planit vjetor të pranimit në shërbimin civil) institucioni Bashkia Kamëz, nuk e ka formalizuar shkresërisht në planin vjetor të pranimit të hartuar dhe miratuar për vitet 2021 dhe 2022, (vite në të cilën janë formalizuar planet e pranimit



pasi më parë nuk janë hartuar), pavarësisht aplikimit në të gjithë periudhën objekt mbikëqyrje.

Për periudhën shtator 2019- mars 2022, janë realizuar **20** procedura konkurrimi me kandidat nga jashtë shërbimit civil, nga të cilat, **7** procedura janë realizuar për pozicionin “*Drejtor Drejtorie*” dhe **13** procedura janë realizuar për plotësimin e pozicionit “*Përgjegjës Sektori*”.

Në përfundim të procedurave të realizuara, nga titullari i institucionit janë nxjerr aktet e emërimit për **20** konkurrentët të shpallur fitues. Në të gjitha rastet, konstatohet mungesa e aktit të Kryetarit të Bashkisë, për të planifikuar këto pozicione me emërim nga jashtë shërbimit civil. Njësia përgjegjëse ka vepruar në tejkalim të kompetencave.

Në të **20** procedurat e konkurrimin për pranimin nga jashtë shërbimit civil, për plotësimin e pozicioneve të **kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues** me emërtesën “*Përgjegjës sektori*” dhe “*Drejtor Drejtorie*”, janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore të parashikuara në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 242, datë 18.03.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar, ndër të cilat: mungesa e shpalljes së pozicionit të lirë; mosngritja e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë; mungesa e akteve administrative që dokumentojnë fazat e testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë. Mungesa e këtyre akteve administrative të domosdoshme, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimin, passjell pavlefshmërinë e procesit. Konkretisht, sipas elementëve të pavlefshmërisë të konstatuar në procedurat e konkurrimin, gjendja paraqitet si më poshtë vjon:

✓ Procedura është zhvilluar duke mos respektuar kërkesën e publikimit të pozicionit vakant në portalin “*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*” dhe në stendat e informimit të publikut apo në faqen zyrtare të institucionit, pika 6, e Kreut II, të VKM-së nr.242, datë 18.03.2015, i ndryshuar; Nuk ka dalë urdhëri për ngritjen e KPND-së, në zbatim të pikës 7, të Kreut III, të kësaj VKM-je, nuk janë administruar në dosjen e konkurrimin, aktet administrative që dokumentojnë fazat e testimit. Me këto mangësi, evidentohen pozicionet:

1. “*Përgjegjës i Arsimit Parashkollor*”, me aktin nr. 268, datë 26.12.2019, të Kryetarit, është emëruar punonjësja \*\*\*\*\*.
2. “*Përgjegjës i IT*”, Drejtorja e Transportit, Lejeve dhe Liçensave IT, me aktin nr.1/4, datë 21.10.2019, të Kryetarit, është emëruar punonjësja \*\*\*\*\* (me aktin nr.101, datë 01.02.2022, punonjësi është emëruar “*Specialist IT*”, emërim i përkohshëm).

3. “Përgjegjës i Sektorit të Licensave”, me aktin nr. 571, datë 11.11.2020, të Kryetarit, është emëruar punonjësi \*\*\*\*\* (me aktin nr. 604, datë 18.11.2020, punonësi është emëruar “Veteriner”, emërim i përkohshëm).
  4. “Përgjegjës i Ndihmës Ekonomike”, lagjja Bathore, me aktin nr. 131, datë 17.03.2020, të Kryetarit, është emëruar punonjësja \*\*\*\*\* (nuk vërtetohet nëse punonjësja plotëson kriterin arsimor të kërkuar, Master Profesionale me 120 kredite për pozicionin e punës).
  5. “Përgjegjës i Lagjes nr. 2”, me aktin nr. 368, datë 14.08.2020, të Kryetarit, është emëruar punonjësja \*\*\*\*\*.
  6. “Përgjegjës i Sektorit të Strehimit”, me aktin nr. 516, datë 13.10.2020, të Kryetarit, është emëruar punonjësja \*\*\*\*\*.
  7. “Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, me aktin nr.589, datë 24.10.2019, të Kryetarit, është emëruar punonjësi \*\*\*\*\*.
  8. “Drejtor i Arsimit Rinisë dhe Sportit”, me aktin nr. 95, datë 18.02.2020, të Kryetarit, është emëruar punonjësja \*\*\*\*\* (me aktin nr. 598, datë 15.11.2021, të Kryetarit, punonjësja është emëruar në pozicionin “Drejtor i Kulturës”, emërim i përkohshëm).
- ✓ Procedura të zhvilluara pa u respektuar kërkesa e publikimit të pozicionit vakant në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në stendat e informimit të publikut, apo në faqen zyrtare të institucionit, pika 6, e Kreut II, të VKM-së nr.242, datë 18.03.2015, i ndryshuar; si dhe mungesës së urdhërit për ngritjen e KPND-së, në zbatim të pikës 7, të Kreut III, të kësaj VKM-je për pozicionet:
1. “Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit të Detyrimit & Menaxhimit Borxhit”, me aktin nr. 123, datë 09.03.2020, të Kryetarit, është emëruar punonjësja \*\*\*\*\* (pozicioni është shpallur, por në përmbajtje të shpalljes, nuk janë përfshirë kriteret e përgjithshme dhe të posaçme për pranim në shërbimin civil).
  2. “Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore”, me aktin nr. 599, datë 25.10.2019, të Kryetarit, është emëruar punonjësi \*\*\*\*\* (Aktualisht, ky punonjës me aktin nr.270, datë 16.03.2022, të Kryetarit, është urdhëruar të mbulojë përkohësisht zyrën e gjendjes civile)
- ✓ Procedura të zhvilluara pa u respektuar kërkesa e parashikuar në pikën 7, të Kreut III, të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, të ndryshuar, ngritja e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë, për pozicionin:
1. “Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit”, me aktin nr. 294, datë 07.07.2020, të Kryetarit, është emëruar punonjësi \*\*\*\*\*.

2. “Përgjegjës pranë Drejtorisë së MTPM”, me aktin nr. 257, datë 22.06.2020, të Kryetarit, është emëruar punonjësja \*\*\*\*\* (me Urdhrin nr. 199, datë 01.06.2020, punonjësja është emëruar “Përgjegjës kadastrë”, emërim i përkohshëm).
  3. “Përgjegjës i Medias dhe Informimit”, me aktin nr. 297, datë 07.07.2020, të Kryetarit, është emëruar punonjësi \*\*\*\*\*.
  4. “Përgjegjës i Zyrës së Projektimit”, me aktin nr. 228, datë 09.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë, është emëruar punonjësi \*\*\*\*\*.
  5. “Përgjegjës i Rindërtimit”, me aktin nr. 298, datë 01.04.2022, të Kryetarit të Bashkisë, është emëruar punonjësja \*\*\*\*\*.
  6. “Përgjegjës i Analizës dhe Kontabilizimit të Detyrimeve”, me aktin nr. 53, datë 24.01.2022, të Kryetarit, është emëruar punonjësja \*\*\*\*\* (punonjësja nuk plotëson kriterin arsimor për pozicionin e punës, zotëron vetëm nivelin Bachelor në Administrim Biznesi).
  7. “Drejtor i Drejtorisë së Licensave dhe Transportit”, me aktin nr. 272, datë 16.03.2022, të Kryetarit, është emëruar punonjësi \*\*\*\*\*.
- ✓ Procedura të zhvilluara duke mos respektuar kërkesën e parashikuar në pikën 7, të Kreut III, të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar, ngritja e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë, si dhe si dhe në kushtet e mungesës së akteve administrative që dokumentojnë fazat e testimit, për pozicionet:
1. “Drejtor në Drejtorinë e Integritit në BE dhe Projekteve të Huaja”, me aktin nr.445, datë 14.09.2020, të Kryetarit, është emëruar punonjësja \*\*\*\*\*.
  2. “Drejtor i Drejtorisë së Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun”, me aktin nr. 69, datë 08.02.2021, të Kryetarit, është emëruar punonjësi \*\*\*\*\*.
  3. “Drejtor i Qendrës së Kulturës”, me aktin nr. 59, datë 03.02.2020, të Kryetarit, është emëruar punonjësi \*\*\*\*\* (me aktin nr. 631, datë 21.11.2021, të Kryetarit, punonjësi është emëruar në pozicionin “Drejtorisë së Arsimit Rinisë dhe Sportit”, emërim i përkohshëm).

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se, procedurat e konkurrimit të zhvilluara për plotësimin e pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, nëpërmjet procedurës me pranim nga jashtë shërbimit civil, për të gjitha pozicionet e përmendura më lartë, nuk janë realizuar sipas përcaktimeve të nenit 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët

*drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.*

- Njësia përgjegjëse ka vepruar në tejkalim të kompetencave, pasi në mungesë të vendimit të Kryetarit të Bashkisë, i ka kualifikuar kandidatët për pranim nga jashtë shërbimit civil. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 108, “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm*”, i Kodit të Procedurave Administrative, aktet e emërimit të nxjerra për punonjësit e emëruar në këto pozicione pune, në kundërshtim të hapur me kompetencën e organit publik, si dhe me procedurën e nxjerrjes së tij, duhet të konstatohen si akte absolutisht të pavlefshme nga ana e këtij organi.
- Pozicionet të rishpallen për tu plotësuar në përputhje me kërkesat e institutit të rekrutimit në shërbimin civil, pasi të ketë përfunduar procesi i standartizimit të emërtesave të pozicioneve nëpërmjet procesit të riklasifikimit të tyre.
- Ndërsa për 4 punonjësit e kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, të pranuar nga jashtë shërbimit civil, nëpërmjet procedurave të konkurrimit në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, të paraqitur si më poshtë:
  - ✓ \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, emëruar “*Përgjegjës i Arsimit Parashkollor*”, me aktin nr.268, datë 26.12.2019, të Kryetarit të Bashkisë.
  - ✓ \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, emëruar “*Përgjegjës i Lagjes nr. 2*”, me aktin nr. 368, datë 14.08.2020, të Kryetarit të Bashkisë.
  - ✓ \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, emëruar “*Përgjegjës pranë Drejtorisë së MTPM*”, me aktin nr. 257, datë 22.06.2020, të Kryetarit të Bashkisë dhe aktualisht, me aktin nr.199, datë 01.06.2020, të Kryetarit, është emëruar “*Përgjegjës kadastrë*”.
  - ✓ \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, emëruar “*Drejtor i Qendrës së Kulturës*”, me aktin nr. 59, datë 03.02.2020, të Kryetarit të Bashkisë dhe aktualisht, me aktin nr. 631, datë 21.11.2021, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Drejtorisë së Arsimit Rinisë dhe Sportit*”,

fillimisht duhet të saktësohet raporti i pozicionit të punës me shërbimin civil dhe nëse vlerësohet me tipare të shërbimit civil, atëherë të vepohet si më lartë, duke ndërprerë marrëdhënien e punësimit dhe shpalljen e pozicionit të lirë për tu plotësuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

c) **Plotësimi i pozicionit të kategorisë së nivelit të lartë drejtues, “Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Publike”**

Rregullat procedurale të konkurrimit për të plotësuar pozicionet e punës në kategorinë e nivelit të lartë drejtues, (lëvizja paralele/ ngritja në detyrë/ pranim nga jashtë shërbimit

*civil*), në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të parashikuara në nenin 32, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr.118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”.

Grupi i mbikëqyrjes këqyri dokumentacionin e administruar në dosjen e konkurrimit për plotësimin e pozicionit të punës, “Drejtor i Përgjithshëm”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit, Zhvillimit, Kontrollit të Territorit dhe Investimeve, pozicioni i kategorisë së nivelit të lartë drejtues, në institucionin e kontrolluar rezultoi se, procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, për plotësimin e vendit vakant paraqitet si më poshtë vijon:

- ✓ Mungon akti i Kryetarit të Bashkisë për plotësimin e pozicionit të kategorisë së nivelit të lartë drejtues, përmes pranimit nga jashtë shërbimit civil.
- ✓ Njësia përgjegjëse, nuk ka kryer publikimin e shpalljes së procedurës për plotësimin e vendit vakant, në kategorinë e nivelit të lartë drejtues, në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”; në Faqen Zyrtare; si dhe në stendën e informimit të publikut të institucionit.
- ✓ Në dosjen e konkurrimit gjendet njoftimi për shpallje me nr. 48 prot., datë 15.05.2020, në të cilën është planifikuar procedura e konkurrimit për pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit, Zhvillimit, Kontrollit të Territorit dhe Investimeve, pranë Bashkisë Kamëz, akti i nxjerr nga Bashkia Kamëz, pa firmosur. Sipas njoftimit procedura është hapur *për lëvizje paralele/ngritje në detyrë/pranim nga jashtë shërbimit civil*, kategoria e pagës II-a. Lloji i diplomës i kërkuar është *Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi/Arkitekturë/Planifikim dhe Menaxhim Urban/Urbanistikë*. Eksperiencia në punë, 5 vjet.

**Kritere të veçanta:** *Të ketë eksperiencë në OJF; eksperiencë në implementimin e projekteve të huaja të financuara nga EBRD/WB/KFW; njohuri mjaft të mira të një gjuhe të BE.*

Konstatohet se, kriteret e veçanta në lidhje me përvojën në punë janë përcaktuar shumë specifike, duke e kufizuar numrin e kandidatëve të mundshëm për tu kualifikuar për këtë pozicion pune, ç’ka nënkupton se këto kritere në mënyrë subjektive janë vendosur me qëllim kualifikimin e kandidatit në fjalë.

Gjithashtu, kjo procedurë konkurrimi për plotësimin e pozicionit vakant në kategorinë e nivelit të lartë drejtues është e hapur edhe për pranim nga jashtë shërbimit civil, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 32, të ligjit 152/2013, i

ndryshuar, i cili lejon organin vendimmarrës të institucionit të vendosë që procedura e pranimit të jetë e hapur edhe për kandidatët e tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike, por në asnjë rast ky numër nuk mund të jetë më shumë se 15 për qind të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kategorisë së lartë drejtuese për atë institucion, në rastin konkret, mungon vendimi i Kryetarit të Bashkisë.

- ✓ Në njoftimin për shpallje është planifikuar *lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranimi nga jashtë shërbimit civil*, duke përcaktuar për procedurën e lëvizjes paralele, afatin e dorëzimit të dokumentacionit/verifikimi paraprak, datën 05.06.2020; për procedurën e ngritjes në detyrë, afatin e dorëzimit të dokumentacionit/verifikimi paraprak, datën 10.06.2020; për procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil, dorëzimi i dokumentacionit/verifikimi paraprak, datën 15.06.2020.

Konstatohet se, nuk janë respektuar kërkesat e parashikuara në pikat 7 deri 10, të Kreut VIII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 05.03.2014, “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së*”, i ndryshuar, sa i takon afatit të dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët, si dhe afatit të verifikimit paraprak, nga ana e njësisë përgjegjëse.

- ✓ Komiteti i Përhershëm i Pranimit për pranimin në kategorinë e nivelit të lartë drejtues është i njëjtë me Komitetin e Përhershëm të Pranimit, në kategorinë ekzekutive, ngritur me vendimin nr. 229, datë 09.06.2020, të titullarit të institucionit, me përbërje:

- a. \*\*\*\*\* (Zv. Kryetar/Drejtor Kabineti);
- b. \*\*\*\*\* (Përgjegjës i Burimeve Njerëzore);
- c. \*\*\*\*\* (Drejtor i Financës dhe Kontabilitetit);
- d. \*\*\*\*\* (Ekspert i Jashtëm);
- e. \*\*\*\*\* (Ekspert i Jashtëm).

- ✓ Pas verifikimit paraprak, me shkresën nr. 48/3 prot., datë 15.06.2020, “*Njoftim për vazhdimin e procedurave të pranimit*”, është njoftuar se konkursi do vazhdojë me procedurën e pranimit në shërbimin civil, dhe se \*\*\*\*\* është kandidati i kualifikuar për këtë fazë konkurrimi.

Në këtë rast, nuk është respektuar parashikimi i pikës 9, të Kreut VIII, të VKM-së nr.118, datë 05.03.2014, i ndryshuar, pasi njësia përgjegjëse duhet të bënte verifikimin paraprak të dosjeve të kandidatëve nëse plotësonin kriteret specifike. Në përfundim të afatit (*brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar, për dorëzimin e dokumentacionit*), njësia përgjegjëse duhet të shpallte në portalin “*Agjencia*

*Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*”; në faqen zyrtare të internetit dhe në ambientet e përcaktuara nga njësia e qeverisjes vendore, listën e aplikuesve që plotësonin kriteret specifike, për t’iu nënshtruar konkursit, duke i renditur ata sipas rendit alfabetik.

- ✓ Në dosjen e konkurrimit nuk gjenden aktet administrative të kërkuara, të cilat dokumentojnë fazat e konkurrimit, të testimit me shkrim dhe intervistën e strukturuar me gojë.

Me shkresën e KPP-së me nr. 48/4 prot., datë 19.06.2020, “*Njoftim për shpallje rezultati*”, në përfundim të procedurës me shkrim dhe me gojë është shpallur emri i kandidatit fitues \*\*\*\*\*, për pozicionin “*Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit, Zhvillimit, Kontrollit Territorit dhe Investimeve në Infrastrukturë*”, në Bashkinë Kamëz, me rezultatin 86 pikë.

Rezultati i fituesit, nga ana e njësisë përgjegjëse, nuk është publikuar në portalin “*Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*”; në faqen zyrtare të internetit dhe në ambientet e përcaktuara nga njësia e qeverisjes vendore, në respektim të kërkesave të pikës 14, të Kreut VIII, të VKM-së nr. 118, datë 05.03.2014, “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së*”, i ndryshuar.

- ✓ Në përfundim të vlerësimit nga Komiteti, titullari i institucionit ka nxjerr aktin e emërimit nr. 254, datë 22.06.2020, për kandidatin fitues \*\*\*\*\*, ndërkohë që, është njësia përgjegjëse, organi kompetent për nxjerrjen e aktit të emërimit. Ky akt del brenda 2 (dy) ditëve pune nga marrja dijeni nga KPP për kandidatin e shpallur fitues, në bazë të propozimit për për zgjedhjen e kandidatit/kandidatëve nga eprori direkt, (pika 2, e Kreut IX, të VKM-së nr. 118, datë 05.03.2014, i ndryshuar).

Në mbështetje të sa më lart përmendur, sjellim në vëmendje të njësisë përgjegjëse të institucionit, se në kushtet kur ndodhet përpara pamundësisë së plotësimit të pozicioneve të kategorisë së nivelit të lartë drejtues me konkurrim të hapur, si në rastin konkret, legjislacioni i shërbimit civil i njeh të drejtën, për ti plotësuar këto pozicione me pranim nga jashtë shërbimit civil, në respektim të dispozitës përkatëse, që është pika 1, neni 32, “*Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore*”, në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Ky rregull ligjor i jep tagrin titullarit/organit vendimmarrës të institucionit të vendosë që procedura e pranimit të jetë e hapur edhe për kandidatët e tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, me kushtin që ky numër të

mos jetë më shumë se 15 për qind të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kategorisë së lartë drejtuese për institucionin.

Komisioneri çmon se, në rastin e emërimit të punonjësit \*\*\*\*\*, titullari i institucionit nuk e ka nxjerrë aktin fillestar që të mundësojë fillimin e procedurës për pranimin nga jashtë shërbimit civil. Si rrjedhim, ky emërim në kategorinë e nivelit të lartë drejtues, është kryer në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë ligj, dhe për këtë arsye është absolutisht i pavlefshëm.

Gjithashtu, konstatohet se, procedura e konkurrimit nuk ka ndjekur kërkesat ligjore dhe nënligjore të parashikuara VKM-së nr. 118, datë 05.03.2014, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar.

**Konkluzion:** Në rastin e emërimit të punonjësit \*\*\*\*\*, titullari i institucionit duhet të konstatojë pavlefshmërinë e aktit të emërimit në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit, Zhvillimit, Kontrollit të Territorit dhe Investimeve në Infrastrukturë”, pasi procedura e konkurrimit nuk ka ndjekur kërkesat ligjore dhe nënligjore për pranimin nga jashtë shërbimit civil, për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, të parashikuara në VKM-në nr. 118, datë 05.03.2014, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, kreu I, germa ç) dhe kreu III.

- Njësia përgjegjëse ka vepruar në tejkalim të kompetencave, pasi në mungesë të vendimit të Kryetarit të Bashkisë, ka kualifikuar kandidatët për pranim nga jashtë shërbimit civil.
- Pozioni të rishpallet për tu plotësuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

### **III. Evidentimi i rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil (emërime me kontratë apo me akt të thjeshtë emërimi në pozicione të shërbimit civil si dhe lëvizje në një detyrë tjetër të nëpunësve civilë me komandim apo transferim pa u respektuar procedurat ligjore)**

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, së dosjeve të konkurrimit për punonjësit e emëruar në pozicione të shërbimit civil, pranë institucionit Bashkia Kamëz, u konstatua se ka pasur **24 raste** të emërimeve në kundërshtim me ligjin për shërbimin civil, nga të cilat **18 raste** janë emërime me akt të thjeshtë, si dhe në **6 raste** janë kryer emërime në një detyrë tjetër të shërbimit civil, me akt të titullarit të institucionit, duke mos respektuar procedurat ligjore të parashikuara nga instituti i rekrutimit.



✓ *Emërimet në pozicione të shërbimit civil me akt të thjeshtë emërimi,  
të nxjerrë nga titullari i institucionit*

Konkretisht, bëhet fjalë për **18** raste të punonjësve të emëruar me akt të përkohshëm emërimi, të cilët janë evidentuar në vijim sipas emrit, aktit të emërimit dhe pozicionit të punës:

1. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 383, datë 17.07.2019, të Kryetarit, në pozicionin *"Specialist, Sektori i Investimeve dhe Monitorimit të Infrastrukturës "*.
2. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 626, datë 17.12.2020, të Kryetarit, në pozicionin aktual të punës *"Specialist, Sektori i Planifikimit"*.
3. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 285, datë 04.09.2017, të Kryetarit, në pozicionin aktual të punës *"Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit"*.
4. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 23, datë 08.01.2020, të Kryetarit, në pozicionin aktual të punës *"Përgjegjëse e Sektorit të Integritit të BE"*.
5. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 419, datë 26.08.2019, të Kryetarit, në pozicionin *"Specialiste Statistike dhe Sekretare e Kryetarit"*.
6. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 283, datë 25.03.2022, të Kryetarit, në pozicionin *"Specialist i Ndhmës Ekonomike"*.
7. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 17, datë 06.01.2020, të Kryetarit, në pozicionin *"Specialiste e Ndhmës Ekonomike"*.
8. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 51, datë 09.01.2019, të Kryetarit, në pozicionin *"Përgjegjës i Arsimit, Rinisë, Sporteve dhe Konvikteve"*.
9. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 200, datë 07.03.2019, të Kryetarit, në pozicionin *"Specialist i Personelit Parashkollor"*.
10. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 169, datë 23.05.2018, të Kryetarit, në pozicionin aktual të punës *"Specialiste e Prokurimeve Publike dhe Juriste"*.
11. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 600, datë 25.10.2019, të Kryetarit, në pozicionin aktual të punës *"Përgjegjës i taksave dhe tarifave vendore familjare"*.
12. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 338, datë 09.10.2017, të Kryetarit, në pozicionin *"Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore Familjare"*.
13. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 44, datë 18.01.2017, të Kryetarit, në pozicionin *"Specialiste Veterinere dhe Tregu"*.
14. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 391, datë 25.08.2020, të Kryetarit, në pozicionin *"Specialist Jurist, Drejtoria e MTPM"*.
15. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 324, datë 14.06.2021, të Kryetarit, në pozicionin *"Përgjegjës i Bordit të Kullimit"*.
16. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 81, datë 11.02.2021, të Kryetarit, në pozicionin aktual të punës, *"Përgjegjës", Njësia Paskuqan.*

17. \*\*\*\*\*\_ emëruar me urdhrin nr. 20, datë 09.01.2018, të Kryetarit, në pozicionin aktual të punës "*Përgjegjës i Ndhmës Ekonomike dhe PAK*", Njësia Paskuqan.
18. \*\*\*\*\*\_ emëruar me urdhrin nr. 177, datë 01.06.2018, të Kryetarit, në pozicionin "*Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë*", Njësia Paskuqan.

Konstatohet se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. *Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.*

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*", veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

**Konkluzion:** Nisur nga detyrimi i parashikuar në nenin 111, të ligjit nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*", organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Kamëz, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart dhe të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore.

- Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, pasi të jetë vlerësuar fillimisht marrëdhënia e tyre me shërbimin civil. Të gjitha pozicionet që do të deklarohen si pjesë e shërbimit civil duhet të plotësohen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, nëpërmjet procedurave të pranimit, lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.
- Sa i takon punonjësit\_\*\*\*\*\*\_, emëruar "*Përgjegjës i Bordit të Kullimit*", me aktin nr.324, datë 14.06.2021, të Kryetarit të Bashkisë, ky pozicion pune gabimisht është trajtuar si pozicion i shërbimit civil pasi referuar nenit 2, germa k), të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, marrëdhënia e punësimit për punonjësit e bordeve të kullimit, nuk normohen nga ky ligj

✓ *Emërime në kundërshtim me ligjin, në një pozicion tjetër të shërbimit civil me akt të titullarit të institucionit*

Nga procesi i këqyrjes së akteve të emërimit, u konstatua se në **6** raste, titullari i institucionit të mbikëqyrur ka nxjerrë aktin e emërimit në një detyrë tjetër të shërbimit civil, duke mos respektuar procedurat ligjore të parashikuara nga instituti i rekrutimit, për këta punonjës, të cilëve iu është deklaruar më parë statusi si “*nëpunës civil*”, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, si më poshtë:

1. Punonjës *\*\*\*\*\**, me aktin nr. 31 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit si “*nëpunës civil*”, në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*”. Me aktin e përkohshëm, urdhrin nr. 189, datë 01.09.2015, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale*”.
2. Punonjës *\*\*\*\*\**, me aktin nr. 47 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit si “*nëpunës civil*”, në pozicionin “*Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore*”. Me aktin e përkohshëm, urdhrin nr. 269, datë 01.12.2014, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit Terren*”.
3. Punonjës *\*\*\*\*\**, me aktin nr. 25, datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit si “*nëpunës civil*”, në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Infrastrukturës dhe Investimeve*”. Me aktin e përkohshëm, urdhrin nr. 322, datë 14.06.2021, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Infrastrukturës*”.
4. Punonjësi *\*\*\*\*\**, me aktin nr. 11/11 datë 05.01.2015, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit si “*Specialist i Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit*”, Komuna Paskuqan. Më pas, me aktin e përkohshëm të emërimit, urdhrin nr. 145, datë 06.02.2019, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Specialist i Prokurimeve Publike*”, në Bashkinë Kamëz.
5. Punonjësja *\*\*\*\*\**, me urdhrin nr. 79, datë 18.02.2013, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Specialiste protokolli*”. Më pas, me aktin e përkohshëm të emërimit, urdhrin nr. 177, datë 04.06.2014, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Burimeve Njerëzore*”.
6. Punonjësi *\*\*\*\*\**, me urdhrin nr. 605, datë 18.11.2021, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Specialist IT*”. Më pas, me aktin e përkohshëm të Kyetarit, urdhrin nr. 102, datë 01.02.2022, është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës IT*”.

**Konkluzion:** Sa më lart, në mbështetje të dispozitave ligjore të parashikuara në nenet 108, 110 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, aktet e përkohshme të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, për emërimin në një pozicion tjetër të shërbimit civil, për punonjësit *\*\*\*\*\**, *\*\*\*\*\**, *\*\*\*\*\**, *\*\*\*\*\**, duhet të konstatohen si akte absolutisht të pavlefshme nga vetë organi që i ka nxjerr aktet,

në këtë rast Kryetari i Bashkisë, duke urdhëruar njëkohësisht edhe rikthimin e këtyre punonjësve në pozicionet e shërbimit civil, ku i është deklaruar statusi i nëpunësit civil, apo në pozicione të barazvlefshme me këto të fundit, në rast suprimimi të pozicionit.

- Sa i takon, punonjësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, pas konstatimit të pavlefshmërisë së akteve të emërimit të tyre në pozicionet aktuale të shërbimit civil, nga titullari i institucionit, duhet të nxirren aktet për rikthimin e punonjësve në pozicionin “*Specialist*”, ku janë emëruar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.
- Të rregullohen pasojat duke i shpallur të lira këto pozicione, për t’u plotësuar me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, ashtu si e kemi evidentuar edhe më sipër, duke klasifikuar më parë pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil.

#### **IV. Respektimi i kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil, sa i takon institutit të transferimit në shërbimin civil**

Baza ligjore mbi të cilat duhet të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, janë përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, k reu II, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, si dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”.

Gjatë këqyrjes së dosjeve të personelit të punonjësve pranë Bashkisë Kamëz, u konstatua se, për 12 punonjës, njësia përgjegjëse ka nxjerr aktet e deklarimit të statusit të punësimit si “*nëpunës civilë*”, në pozicionet e punës, ku këta punonjës kanë qenë të emëruar në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar. Por, me vijimin e marrëdhënies së punësimit, punonjësit janë transferuar në pozicione të së njëjtës kategori të nëpunësisë civile, me akt të Kryetarit të Bashkisë, ku i është deklaruar statusi apo në një pozicion të shërbimit civil të një kategorie më të ulët, duke mos respektuar kërkesat ligjore që rregullojnë institutin e transferimit në shërbimin civil. Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 17 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit në pozicionin “*Specialist i Mbrojtjes së Tokës dhe*

- Përmirësimin*”, e në vijim, me aktin nr. 270, datë 29.06.2020, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Specialist, Sektori i Investimeve dhe Monitorimit të Infrastrukturës*”.
2. \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, me aktin nr. 20 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit në pozicionin “*Specialist, Sektori i Planifikimit të Territorit*”, e në vijim, me aktin nr. 440, datë 02.09.2021, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Specialist i Infrastrukturës dhe Investimeve*”.
  3. \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, me aktin nr. 21 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit në pozicionin “*Përgjegjës, Sektori i Zhvillimit dhe Regjistrimit të Territorit*”, e në vijim, me aktin nr. 280, datë 04.09.2017, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Specialist, Sektori i Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit*”.
  4. \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, me aktin nr. 12 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit në pozicionin “*Drejtor i Rajonit Bathore*”, në vijim, duke qenë se pozicioni është suprimuar, me urdhër të Kryetarit nr. 439, datë 02.09.2021, është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Emërgjencave Civile*”.
  5. \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, me aktin nr. 38 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit në pozicionin “*Specialist i Rajonit Bathore*”, e në vijim, me aktin nr. 06, datë 06.01.2020, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Specialist i Strehimit Social*”.
  6. \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, me aktin nr. 33 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Arsimit*”, e në vijim, me urdhrin nr. 15, datë 03.01.2019, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Specialist i Financës*”, pas kërkesës së punonjësës datë 19.12.2018.
  7. \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, me aktin nr. 3 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit në pozicionin “*Specialiste, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore*”, e në vijim, me aktin nr. 304, datë 11.09.2017, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Specialiste e Paaftësisë*”.
  8. \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, me aktin nr. 11/11 prot., datë 05.01.2015, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit në pozicionin “*Specialist i Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit*”, e në vijim, me aktin nr. 145, datë 06.02.2019, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Specialist i Prokurimeve Publike*”.
  9. \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, me aktin nr. 18 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit në pozicionin “*Përgjegjës, Sektori i Mbrojtjes së Tokës dhe Përmirësimin të Mjedisit*”, e në vijim, me aktin nr. 60, datë 15.02.2018, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Specialist i Mbrojtjes së Tokës dhe Përmirësimin të Mjedisit*”.
  10. \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, me aktin nr. 11/13 prot., datë 05.01.2015, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit në pozicionin “*Specialist Jurist, Komuna Paskuqan*”, e në

vijim, me aktin nr. 392, datë 25.08.2020, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist i MTPM-së*”.

11. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 11/14 prot., datë 05.01.2015, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit në pozicionin “*Përgjegjës, Sektori i MMT, Komuna Paskuqan*”, e në vijim, me aktin nr. 11, datë 06.01.2020, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Specialist i MTPM-së*”.
12. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 11/19 prot., datë 05.01.2015, të njësisë përgjegjëse, i është deklaruar statusi i punësimit në pozicionin “*Përgjegjës i Burimeve Njerëzore, Komuna Paskuqan*”, e në vijim, duke qenë se pozicioni është suprimuar, me aktin nr. 356, datë 11.07.2016, të Kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Specialist i Burimeve Njerëzore, Komuna Paskuqan*”.

Rezulton se, për të gjitha rastet e emërimit të punonjësve të cituar më lart, me akt të Kryetarit të Bashkisë, nuk janë respektuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, të cilat normojnë institutin e transferimit të përhershëm në shërbimin civil, të parashikuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; në Kreun II, III dhe IV, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”.

Në rastin konkret, në mbështje të pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, parashikohet se, në çdo rast mbylljeje apo ristrukturimi të institucionit, duhet të krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike.

Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse, në bazë të propozimit të komisionit.

**Konkluzion:** Komisioneri çmon se, aktet e emërimit në pozicionet e reja të shërbimit civil, për të **12** punonjësit e cituar më lart, janë nxjerrë nga titullari i institucionit, pa ndjekur procedurën dhe kërkesat ligjore të parashikuara për këtë rast, por nga ana tjetër, duke qenë se, të **12** punonjësit, i plotësojnë kriteret e posaçme të pozicionit ku janë Aktualisht, të punësuar, gjithashtu secili prej tyre e ka pranuar pozicionin e ri, në të cilin është emëruar me akt të Kryetarit të Bashkisë, vlerësohet se, këta punonjës duhet të vijojnë marrëdhënien e punësimit në pozicionet e punës ku janë aktualisht, të emëruar.

Në këtë rast, i tërhiqet vemendja njësisë përgjegjëse dhe titullarit të institucionit, që në vijim, çdo transferim i punonjësve të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, duhet të kryhet me vendim të njësisë përgjegjëse, pas propozimit të nxjerr nga Komisioni i Ristrukturimit, i cili duhet të krijohet në të gjitha rastet e ristrukturimit të institucionit, sipas kërkesave ligjore të sanksionuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; në Kreun II, III dhe IV, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”*.

#### **V. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës**

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u verifikua përmbushja e kërkesave ligjore të periudhës së provës, të përcaktuara nga neni 24, i ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe Kreu VI, i Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*.

Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, nëpunësi në periudhë prove është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe të nxjerr vendimin për përfundimin e periudhës së provës.

Në zbatim të planit të mbikëqyrjes, grupi i punës verifikoi tërësinë e veprimeve të kryera për konfirmimin e nëpunësve civilë, të cilët duhet ti nënshtroheshin periudhës së provës dhe që Aktualisht, vazhdojnë marrëdhëniet e punësimit me institucionin.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, vijojnë të jenë në periudhë prove 26 punonjës, të emëruar në pozicione të kategorisë ekzekutive, aktet e emërimit për të cilët kanë dalë në vitin 2020, 2021 dhe 2022. Referuar aktit të emërimit të secilit punonjës, vërehet se, në disa raste afati i parashikuar për periudhën e provës nuk ka përfunduar, ose edhe pse kjo periudhë duhet të kishte përfunduar brenda afateve ligjore të përcaktuara, nga ana e njësisë përgjegjëse dhe/apo eprorit direkt, nuk janë ndërmarrë veprimet e kërkuara ligjore dhe nënligjore, të detyrueshme gjatë kësaj periudhe.

Konkretisht, rezulton se për vitin 2022, **12** procedura rekrutimi kanë rezultuar të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, në përfundim të së cilave janë emëruar **12** punonjës. Rezulton se, nga ana e njësisë përgjegjëse nuk janë nxjerr aktet emërimit për herë të parë në shërbimin civil, për këta punonjës, si “*nëpunës civilë në periudhë prove*”, për të vijuar me tej me fazat e tjera nëpër të cilat kalon ky proces, në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 24, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar. Bëhet fjalë për punonjësit:

1. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 215, datë 01.03.2022, të Kryetarit, në pozicionin e punës “*Specialist Auditimi*”.
2. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 213, datë 01.03.2022, të Kryetarit, në pozicionin e punës “*Specialist Auditimi*”.
3. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 195, datë 24.02.2022, të Kryetarit, në pozicionin e punës “*Specialist Projektimi*”.
4. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 216, datë 01.03.2022, të Kryetarit, në pozicionin e punës “*Specialist i Rindërtimit*”.
5. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 218, datë 01.03.2022, të Kryetarit, në pozicionin e punës “*Specialist i Sektorit të Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit*”.
6. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 193, datë 24.02.2022, të Kryetarit, në pozicionin e punës “*Specialist Koordinator Turizmi*”.
7. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 191, datë 24.02.2022, të Kryetarit, në pozicionin e punës “*Specialist i Strehimit Social*”.
8. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 227, datë 09.03.2022, të Kryetarit, në pozicionin e punës “*Specialist i Buxhetit dhe Financës*”.
9. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 194, datë 24.02.2022, të Kryetarit, në pozicionin e punës “*Specialist i PAK*”.
10. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 196, datë 24.02.2022, të Kryetarit, në pozicionin e punës “*Specialist Jurist*”.
11. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 192, datë 24.02.2022, të Kryetarit, në pozicionin e punës “*Specialist Strehimi*”.
12. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 282, datë 25.03.2022, të Kryetarit, në pozicionin e punës “*Specialist i Ndihmës Ekonomike*”.

E njëjta situatë paraqitet edhe për **13** punonjës të emëruar në kategorinë ekzekutive, në vitin 2021 dhe **1** punonjës të emëruar në këtë kategori në vitin 2020, për të cilët njësia përgjegjëse dhe eprori direkt, nuk kanë nxjerrë aktet ligjore të kërkuara gjatë periudhës së provës, duke e lënë të papërcaktuar statusin për këta punonjës, ata janë:



1. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 378, datë 13.07.2021, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist Auditimi*".
2. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 86, datë 15.02.2021, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist, Sektori i Investimeve dhe Monitorimit të Infrastrukturës*".
3. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 294, datë 02.06.2021, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist i Rindërtimit*".
4. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 52, datë 27.01.2021, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist i Sektorit të Planifikimit të Territorit*".
5. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 365, datë 06.07.2021, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist i Sektorit të Planifikimit të Territorit*".
6. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 442, datë 07.09.2021, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist i Emergjencave Civile*".
7. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 61, datë 03.02.2021, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist në Drejtorinë e Liçensave dhe Transportit*".
8. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 605, datë 18.11.2021, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist IT*".
9. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 104, datë 23.02.2021, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist Veteriner*".
10. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 106, datë 23.02.2021, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist i Analizës dhe Kontabilizmit të Detyrimeve*".
11. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 107, datë 23.02.2021, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist i Analizës dhe Kontabilizmit të Detyrimeve*".
12. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 103, datë 23.02.2021, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist i Analizës dhe Kontabilizmit të Detyrimeve*".
13. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 596, datë 15.11.2021, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist i Strehimit*".
14. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 371, datë 14.08.2020, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist i Ndihmës Ekonomike, Lagjja nr. 2*".

**Konkluzion:** Nga sa u analizua më sipër, për **26** punonjësit të cilët janë emëruar në pozicione të kategorisë ekzekutive pjesë e shpërbimit civil, të cilët janë ende në periudhë prove, të evidentuar sipas pozicioneve përkatëse si më lart, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse në bashkëpunim me eprorin direkt dhe nëpunësin civil në periudhë prove, të përmbushin kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore të kërkuara gjatë periudhës së provës, të parashikuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*", i ndryshuar, si krijimi i kushteve për të ndjekur trajnimin në ASPA dhe ndjekjen e nëpunësve të rinj, nëpërmjet punonjësve me përvojë të institucionit. Në përfundim të periudhës së provës të nxirren aktet e konfirmimit, nëse nuk ka raste të shtyrjes së periudhës së provës

❖ Për të gjitha rastet e tjera, për pranimin në shërbimin civil, të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, u verifikua përmbushja e kërkesave ligjore të periudhës së provës në bazë të të cilave, rezultoi se, për **12** punonjës, të emëruar në pozicione të kategorisë ekzekutive, në vitin 2020, në dosjet personale të tyre, nuk janë të administruara formularët e vlerësimit në përfundim të periudhës së provës, bëhet fjalë për punonjësit:

1. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 258, datë 22.06.2020, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist i Projektimit*".
2. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 98, datë 18.02.2020, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist, në Sektorin e Menaxhimit të Borxhit*".
3. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 320, datë 22.07.2020, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist i Buxhetit dhe Financës*".
4. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 321, datë 22.07.2020, të Kryetarit, në pozicionin "*Specialist i Arsimit dhe Sportit*".
5. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 642 datë 29.12.2020, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist Jurist*".
6. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 115, datë 27.02.2020, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist i Sektorit të Liçensave*".
7. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 113, datë 26.02.2020, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist në Sektorin e Transportit, Lejeve, Liçensimit*".
8. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 101, datë 19.02.2020, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialiste, në Sektorin e Menaxhimit të Borxhit*".
9. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 55, datë 03.02.2020, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit*".
10. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 54, datë 03.02.2020, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist i Mbrojtjes së Konsumatorit*".
11. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 418, datë 03.09.2020, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Specialist i MTPM*".
12. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 522, datë 15.10.2020, të Kryetarit, në pozicionin e punës "*Koordinator e të Drejtës së Informimit*".

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se, për **12** punonjësit e emëruar në pozicione të kategorisë ekzekutive, të cituar më lart, eprori direkt në bashkëpunim me njësisë përgjegjëse, si palë të përfshira në këtë proces, duhet të përfundojnë procesin e vlerësimit për periudhën e provës dhe formularët e vlerësimit të bëhen pjesë e dosjes së secilit punonjës, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, të parashikuara në VKM-në nr. 243, datë 18.03.2015, "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*", i ndryshuar.

- Gjithashtu, me qëllim përmbylljen e periudhës së provës, për punonjësit e evidentuar secili në Aneksin nr. 1, rubrika shënime, pjesë e raportit, njësia përgjegjëse dhe eprori direkt, si palë të përfshira në procesin e periudhës së provës, duhet të sigurohen që të gjithë punonjësit: a) të kryejnë *“Trajnimin e detyrueshëm pranë ASPA”*; b) të kryhet vlerësimi në përfundim të periudhës së provës për secilin punonjës nga ana e eprorit direkt; c) si dhe të deklarohet statusi i punësimit në përfundim të periudhës së provës, sipas kërkesave të pikës 6 dhe 7, të Kreut VI, *“Periudha e Provës”*, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar.

## **VI. Verifikimi i ligjshmërisë së procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, gjatë hetimit të disa informacioneve të ardhura nga nëpunës civilë të Bashkisë Kamëz, në përmbajtjen e të cilave janë ngritur pretendime për parregullsi të lejuara në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhat e vlerësimit janar - qershor dhe korrik - dhjetor, të vitit 2021, ka vlerësuar se zbatimi i ligjshmërisë në realizimin e procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në këtë bashki, si në kohë ashtu dhe në cilësi, paraqet risk të veçantë. Për këtë arsye, me vendimin nr. 84 (266/7 prot.), datë 14.06.2022, të Komisionerit është vendosur që: *“Të bëhet një shtesë në objektin e mbikëqyrjes filluar me vendimin nr. 48 (266 prot.), datë 05.04.2022, të Komisionerit “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në institucionin Bashkia Kamëz”, duke përfshirë në objektin e kësaj mbikëqyrjeje edhe verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë dhe përmbajtjen e këtyre akteve, për periudhat e vlerësimit janar - qershor dhe korrik - dhjetor, të vitit 2021”*.

Ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij i ngarkon nëpunësit e punësuar në kategoritë drejtuese të shërbimit civil shef/përgjegjës sektori, drejtor drejtorie, sekretar i përgjithshëm/drejtor departamenti/drejtor drejtorie të përgjithshme dhe titullarin e institucionit me detyra specifike në administrimin e shërbimit civil. Një nga këto detyra është realizimi i procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë. Kjo kërkesë buron nga neni 62, i ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive ose dobësive të nëpunësve në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj”*.

Më tej, është miratuar Vendimi nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, ku janë përcaktuar në

mënyrë të hollësishme se cilët janë nëpunësit përgjegjës për realizimin e procedurës së vlerësimit; fazat dhe afatin kohor brenda të cilit duhet të kryhen procedurat për të vlerësuar nivelin e realizimit të objektivave të vendosura; vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit; detyrat e zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit; nivelet e shkallëzuara të vlerësimit, si dhe të drejtat e nëpunësit në rastet kur ai nuk është dakord me vlerësimin përfundimtar.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të konfirmuar, është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, brenda vitit kalendarik. Vlerësimi përfundimtar për secilën periudhë vlerësimi realizohet përkatësisht në periudhën 1 - 15 korrik dhe 1 - 15 janar të çdo viti. Ndërsa për nëpunësit civilë në periudhë prove, periudha e vlerësimit është vjetore dhe llogaritet nga data e emërimit në detyrë të nëpunësit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës i kërkoi njësisë së burimeve njerëzore të subjektit të mbikëqyrur, që ti vinte në dispozicion dosjet me materialet shkresore të vlerësimit, të cilat provojnë realizimin e të gjitha fazave të këtij procesi të parashikuara në pikën 12, Kreu II, i VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar, që janë:

- a) Planifikimi;
- b) Bisedimet e ndërmjetme;
- c) Vlerësimi përfundimtar i rezultateve në punë.

Njësia e burimeve njerëzore sqaroi grupin e punës se, nuk ka dosje individuale (shënime, procesverbale, etj.) ku të jenë materializuar të gjitha fazat e vlerësimit, ndërsa “*Formulari i Vlerësimit të Punës*”, si i vetmi dokument që përmban të dhëna në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë është administruar në dosjen e personelit të çdo nëpunësi.

Nga verifikimi i formularëve të vlerësimit të vëna në dispozicion nga sektori i burimeve njerëzore, për periudhat e vlerësimit janar - qershor dhe korrik - dhjetor, viti 2021, u konstatua se:

- ✓ Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë nuk është kryer për të gjithë nëpunësit civilë.
- ✓ Nëpunësit përgjegjës për kryerjen e procedurës së vlerësimit, Zyrtari raportues, Zyrtari kundërfirmues dhe Zyrtari autorizues, në disa raste, nuk janë sipas linjës hierarkike organizative të strukturës së institucionit.

- ✓ Në disa raste procedura e vlerësimit nuk ka përfunduar, pasi nuk është plotësuar ndarja “D”, e titulluar “Nënshkrimi”.
- ✓ Vlerësimi i rezultateve në punë është bërë sipas formatit që jepet në lidhjen nr. 2, bashkëlidhur Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, por, të dhënat që kërkohen në ndarjet/nënndarjet përkatëse të formularit në disa raste nuk janë plotësuar; janë plotësuar pjesërisht; ose janë plotësuar në mënyrë të pasaktë.

Komentet në lidhje me mënyrën se si është plotësuar informacioni që kërkohet në ndarjet A, B, C, Ç, D dhe DH të formularit si dhe dhe nënndarjet e tyre; nëpunësit që kanë kryer detyrën e vlerësimit (*Zyrtari raportues/ Zyrtari kundërfirmues/ Zyrtari autorizues*); nivelin e vlerësimit të përgjithshëm për çdo nëpunës; nënshkrimin nga zyrtarët e vlerësimit si dhe dakordësinë/ kundërshtimin e vlerësimit nga nëpunësi i vlerësuar, i kemi paraqitur në tabelën nr. 1, “*Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të institucionit Bashkia Kamëz*”, të hartuar nga grupi punës dhe që është pjesë e këtij raporti.

Parregullsitë e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në mënyrë të detajuar janë evidentuar, trajtuar dhe analizuar, si më poshtë:

- ✓ ***Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë nuk është kryer për të gjithë nëpunësit civilë***

Për periudhën e vlerësimit janar - qershor, viti 2021, procedura e vlerësimit të rezultateve në punë nuk është kryer për **9** nëpunës, ndërsa për periudhën e vlerësimit korrik - dhjetor, viti 2021, procedura e vlerësimit nuk është kryer për **14** nëpunës. Më konkretisht:

*Për periudhën janar - qershor, viti 2021, nuk janë kryer vlerësime për nëpunësit:*

1. \*\*\*\*\* , “*Specialist në Sektorit të Investimeve dhe Monitorimit të Infrastrukturës*”;
2. \*\*\*\*\* , “*Përgjegjës i Emergjencave Civile*”;
3. \*\*\*\*\* , “*Specialist në Sektorin e Strehimit*”;
4. \*\*\*\*\* , “*Drejtor i Drejtorisë të Financës dhe Kontabilitetit*”;
5. \*\*\*\*\* , “*Specialist në Sektorin e Licencave*”;
6. \*\*\*\*\* , “*Specialist në Sektorin e Licencave*”;
7. \*\*\*\*\* , “*Specialist në Sektorin e Licencave*”;
8. \*\*\*\*\* , “*Specialist Jurist i MTPM-së*”;
9. \*\*\*\*\* , “*Specialist i PAK Bathore*”;

Për periudhën korrik - dhjetor, viti 2021, nuk janë kryer vlerësime për nëpunësit:

1. \*\*\*\*\*, “Specialist Auditimi”;
2. \*\*\*\*\*, “Specialist në Sektorin e Kontrollit e Zhvillimit të Territorit”;
3. \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Emergjencave Civile”;
4. \*\*\*\*\*, “Specialist Finance dhe Buxheti”;
5. \*\*\*\*\*, “Specialist në Sektorin e Licencave”;
6. \*\*\*\*\*, “Specialist në Sektorin e Licencave”;
7. \*\*\*\*\*, “Specialist në Sektorin e Licencave”;
8. \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Njesisë së Prokurimit Publik”;
9. \*\*\*\*\*, “Specialist i Mbrojtjes së Konsumatorit”;
10. \*\*\*\*\*, “Specialist Jurist i MTPM-së”;
11. \*\*\*\*\*, “Specialist i Ndhmës Ekonomike, Lagjia nr. 1”;
12. \*\*\*\*\*, “Specialist i Kadastrës”;
13. \*\*\*\*\*, “Specialist Finance dhe Arkëtar, NJA Paskuqan”;
14. \*\*\*\*\*, “Specialist i Burimeve Njerëzore, NJA Paskuqan”;

Vendimi nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, në Kreun III, i titulluar “Detyrat e nëpunësve të përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë”, në pikat 1, 2, dhe 3, ka përcaktuar detyrat që duhet të kryejë secili nga zyrtarët e vlerësimit. Më tej, në pikën 5, ka parashikuar se, “Mosrealizimi i detyrave të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, të kreut III, të këtij vendimi, konsiderohet “mospërbushje detyre”, nga zyrtarët përkatës”.

Referuar dispozitave si më sipër, moskryerja e procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë, konsiderohet mospërbushje detyre nga zyrtarët përkatës (Zyrtari raportues/ Zyrtari kundërfirmues/ Zyrtari autorizues), më tej në kuptim të përcaktimeve të pikës 3, germa a), të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, “mospërbushja e detyrave”, përbën shkelje të rëndë disiplinore.

Komisioneri çmon se, vlerësimi i mbarëvajtjes në punë nga njëra anë është e lidhur me realizimin e objektivave të çdo pozicioni pune si dhe aftësitë kryesore që nevojiten për kryerjen e detyrave. Por nga ana tjetër, ky proces nxit punonjësit për rritjen e performancës së tyre pasi vlerësimi i fundit në nivelin “Mirë” apo “Shumë mirë”, është parashikuar si kriter që duhet të plotësojnë nëpunësit civilë që duan të konkurrojnë për procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. (VKM nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar, kreu II, pika 2, germa c) dhe kreu III, pika 2, germa c). Gjithashtu në rastin e ristrukturimit të institucionit, vendimmarrja e Komisionit të Ristrukturimit bazohet në sistemin e pikëzimit i cili mundëson vlerësimin me pikë të kritereve kyç që përdoren në procesin e ristrukturimit ku, ndër të tjera, nëpunësit civilë që kanë vlerësimet më të larta

në tre vitet e fundit kanë prioritet në procesin e sistemimit në strukturën e re të institucionit, (udhëzimi nr. 1, datë 01.03.2016, i DAP, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, ankesi nr. 1).

Në rastin e institucionit të mbikëqyrur, moskryerja e procedurave të vlerësimit iu heq nëpunësve mundësinë që të përfitojnë nga disa privilegje që ju njeh ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij siç është e drejta për të konkurruar për një pozicion tjetër pune nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë si dhe përparësia që kanë nëpunësit me rezultate të larta për tu sistemuar në kuadër të ristrukturimit të institucionit.

**Konkluzion:** Në përfundim të analizës së parregullsive të trajtuara si më sipër, Komisioneri arrin në konkluzionin se, nëpunësit e punësuar në pozicionet e shërbimit civil përgjegjës sektori, drejtor drejtorie dhe drejtor drejtorie të përgjithshme nuk kanë kryer procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë që mbikëqyren në mënyrë të drejtëpërdrejtë prej tyre sipas linjës hierarkike organizative të institucionit, detyrë kjo e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, Kreu III, i VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar.

- Për moskryerjen e procedurës së vlerësimit për nëpunësit me emërtesën “*specialist*”, të evidentuar në mënyrë individuale si më lart, janë përgjegjës nëpunësit e ngarkuar me detyrën e zyrtarit raportues/përgjegjësit e sektorëve respektivë ku janë të emëruar këta nëpunës dhe Njësia e burimeve njerëzore e institucionit.

Zyrtari raportues (*përgjegjësi i sektorit në këto raste*), është aktori kryesor i procesit të vlerësimit pasi ai negocion objektivat dhe diskuton vlerësimin përfundimtar me Zyrtarin kundërfirmues dhe Zyrtarin autorizues. Njësia e burimeve njerëzore informon zyrtarët që kanë për detyrë realizimin e procedurës së vlerësimit, ju vë në dispozicion formularin e vlerësimit dhe pasi të jenë përmbyllur të gjitha hapat e procesit i administron ato në dosjen personale të nëpunësit. Sa kohë që, vlerësimi për nëpunësit si më sipër nuk është kryer, Zyrtarët raportues respektivë dhe Njësia e Burimeve njerëzore e institucionit janë përgjegjës për moskryerjen e procedurës.

- Për përmirësimin e situatës së administrimit të shërbimit civil lidhur me realizimin e procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën korrik - dhjetor, viti 2021, për nëpunësit e përmendur në këtë pikë të raportit, Njësia e burimeve njerëzore e institucionit, të informojë zyrtarët e vlerësimit mbi detyrimet e tyre dhe afatet e kryerjes së kësaj detyre, duke ju vënë në dispozicion formularin e vlerësimit dhe të dhënat personale të nëpunësit që kërkohen në ndarjen A, të formularit. Më tej, nëpunësit e përfshirë në procesin e vlerësimit të realizojnë procesin në përputhje me

procedurat e hollësishme të përcaktuara në VKM-në nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar.

- Institucioni i mbikëqyrur, për të gjitha sa është argumentuar më sipër, të analizojë shkaqet e moskryerjes së procedurës së vlerësimit për çdo punonjës të përmendur më sipër duke evidentuar problematikat e hasura dhe të nxjerrë përgjegjësitë personale për secilin zyrtar, e në përfundim të procesit të informojë Komisionerin për masat e marra për zyrtarët që nuk kanë përmbushur detyrën.

**✓ Zyrtarët e vlerësimit (Zyrtari raportues/Zyrtari kundërfirmues/Zyrtari autorizues), në disa raste nuk janë sipas linjës hierarkike organizative të strukturës së institucionit.**

Vendimi nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, ka përcaktuar nëpunësit që kanë për detyrë të kryejnë vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë si dhe procedurën që duhet të ndiqet për realizimin e këtij procesi.

Më konkretisht, në pikën 3, të Kreut II, të aktit nënligjor të cituar më lart është parashikuar se: “Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese kryhet bashkërisht nga zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues”. Ndërsa në germën b), c) dhe ç), të pikës 2, Kreu I, është përkufizuar kuptimi i termit “zyrtar raportues”, “zyrtar kundërfirmues” dhe “zyrtar autorizues”, si më poshtë.

b) “Zyrtar raportues”, nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative nëpunësin që vlerësohet;

c) “Zyrtar kundërfirmues”, nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën hierarkike zyrtarin raportues;

ç) “Zyrtar autorizues”, nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën hierarkike zyrtarin kundërfirmues”.

Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se, disa procedura vlerësimi nuk janë kryer në përputhje me standartet dhe kërkesat e ligjit për shkak se nuk është respektuar linja hierarkike organizative e strukturës së institucionit (nuk është respektuar kompetenca e zyrtarëve për të kryer vlerësimin).

Parregullsitë e konstatuara në lidhje me këtë pikë, janë si më poshtë:



- Në lidhje me vlerësimet e kryera për periudhën janar - qershor, viti 2021:
  - Pothuaj në të gjitha procedurat e vlerësimit të kryera për këtë periudhë Drejtori i Drejtorisë të Burimeve Njerëzore (*R. Hoxha*), ka vepruar në rolin e Zyrtarit kundërfirmues. Ndërkohë, sipas përcaktimeve të aktit nënligjor të cituar më lart, në këtë rol duhet të vepronte nëpunësi që, mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë zyrtarin raportues respektiv të çdo nëpunësi të vlerësuar.
  - Titullari i institucionit/Kryetari i Bashkisë ka vepruar në rolin e Zyrtarit raportues në vlerësimin e Drejtorit të Projekteve dhe Investimeve dhe në rolin e Zyrtarit autorizues në vlerësimin e specialistëve të kësaj drejtorie. Bazuar në linjën hierarkike organizative të institucionit, në këto raste duhet të vepronte Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Publike.
  - Në vlerësimin e specialistëve të Sektorit të Investimeve dhe Monitorimit të Infrastrukturës, në rolin e Zyrtarit raportues ka vepruar Drejtori i Drejtorisë të Projekteve dhe Investimeve. Bazuar në linjën hierarkike organizative të institucionit, në këtë rol paraqitet Përgjegjësi i Sektorit të Investimeve dhe Monitorimit të Infrastrukturës.
  - Në vlerësimin e specialistëve të Sektorit të Kontabilitetit dhe Sektorit të Buxhetit dhe Financës, në rolin e Zyrtarit raportues ka vepruar Drejtori i Financës dhe Kontabilitetit. Bazuar në linjën hierarkike organizative të institucionit, në këtë rol paraqitet Përgjegjësi i Sektorit të Kontabilitetit dhe Përgjegjësi i Sektorit të Buxhetit dhe Financës.
  - Në vlerësimin e specialistëve pranë Lagjes Bathore, Lagjes nr. 1 dhe Njesisë Administrative Paskuqan, në rolin e Zyrtarit raportues dhe Zyrtarit kundërfirmues kanë vepruar administratorët e njësive respektive. Në këtë rast në linjën e zyrtarëve të vlerësimit paraqiten nëpunësit me pozitë më të lartë në Bashkinë Kamëz, gjithmonë sipas linjës së punës që kryen nëpunësi i vlerësuar.
- Në lidhje me vlerësimet e kryera për periudhën korrik – dhjetor, viti 2021:
  - Në vlerësimin e nëpunësit \*\*\*\*\* , Drejtori i Drejtorisë të Burimeve Njerëzore (\*\*\*\*\*), ka vepruar në rolin e Zyrtarit kundërfirmues. Bazuar në linjën hierarkike organizative të institucionit, në këtë rast në rolin e zyrtarit kundërfirmues dhe zyrtarit autorizues paraqitet kryetari i bashkisë.

- Kryetari i Bashkisë ka vepruar në rolin e Zyrtarit autorizues në vlerësimin e specialistëve të Sektorit të Investimeve dhe Monitorimit të Infrastrukturës (\*\*\*\*\*). Bazuar në linjën hierarkike organizative të institucionit, në këto raste duhet të vepronte Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Publike.
- Në vlerësimin e nëpunësit \*\*\*\*\*, Specialist i PAK, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike, në rolin e zyrtarit raportues ka vepruar \*\*\*\*\*, (*ish drejtor i Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale*). Bazuar në linjën e hierarkisë organizative, në këtë rast në rolin e zyrtarit raportues paraqitet Përgjegjësi i Sektorit të Ndihmës Ekonomike.
- Në vlerësimin e nëpunësit \*\*\*\*\*, Specialist i Arsimit dhe Sportit, në Sektorin e Arsimit dhe Sportit, në rolin e zyrtarit raportues ka vepruar \*\*\*\*\*, Drejtor i Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Bazuar në linjën e hierarkisë organizative, në këtë rast, në rolin e zyrtarit raportues paraqitet Përgjegjësi i Arsimit dhe Sportit.

Bazuar në parashikimet e Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, përgjegjës për realizimin e procedurës së vlerësimit janë Zyrtari raportues, Zyrtari kundërfirmues dhe Zyrtari autorizues të cilët bazuar në strukturën organizative të institucionit paraqiten në linjën e eprorëve që mbikëqyrin në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpunësin e vlerësuar.

Referuar strukturës organizative në bazë të të cilës është e organizuar dhe funksionon institucioni Bashkia Kamëz, linja e zyrtarëve të vlerësimit për nëpunësit civilë të kësaj bashkie paraqitet si më poshtë:

*Vlerësimi i nëpunësve me emërtesën “Specialist”*

Zyrtar raportues	përgjegjësi i sektorit;
Zyrtar kundërfirmues	drejtori i drejtorisë;
Zyrtar autorizues	drejtori i përgjithshëm për specialistët e punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Publike/titullari i institucionit për të tjerët.

*Vlerësimi i nëpunësve me emërtesën “Përgjegjës Sektori”*

Zyrtar raportues	drejtori i drejtorisë;
------------------	------------------------

Zyrtar kundërfirmues	drejtori i përgjithshëm për drejtorët e punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Publike/titullari i institucionit për të tjerët;
Zyrtari autorizues	titullari i institucionit.

Vlerësimi i nëpunësve me emërtesën “Drejtor drejtorie”

Zyrtari raportues	drejtori i përgjithshëm për drejtorët e punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Publike/titullari i institucionit për të tjerët;
Zyrtari kundërfirmues	titullari i institucionit;
Zyrtari autorizues	titullari i institucionit.

Vlerësimi i nëpunësve me emërtesën “Drejtor i përgjithshëm”

Zyrtari raportues	titullari i institucionit;
Zyrtari kundërfirmues	titullari i institucionit;
Zyrtari autorizues	titullari i institucionit.

Në rastet kur pozicioni i Zyrtarit raportues, është vend vakant, autoriteti i tij (kompetenca e vlerësimit) në mënyrë të menjëhershme i kalon Zyrtarit kundërfirmues dhe kur për shkak të strukturës ky pozicion mungon, këtë cilësi e merr nëpunësi me pozicion më të lartë sipas linjës hierarkike organizative të institucionit.

- Për vlerësimin në fund të periudhës së provës dhe vlerësimet periodike të punës, të nëpunësve civilë pranë njësive administrative, në përbërje të Bashkisë Kamëz (Njësia Administrative Paskuqan, Lagja Bathore, Lagja nr. 1).

Në lidhje me këtë pikë grupi i punës vlerëson si më poshtë:

Drejtuesit e njësive administrative dhe lagjeve emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Bashkisë dhe janë përgjegjës para tij për funksionimin dhe veprimtarinë e administratës. (Neni 65 dhe neni 67, i ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar). Këta nëpunës janë zyrtarë me detyra kontrolli hierarkik, për njësinë administrative/lagjen përkatëse, por nuk përfshihen në shërbimin civil. Në këto kushte, ata nuk mund të veprojnë si Zyrtar raportues, Zyrtar kundërfirmues apo Zyrtar autorizues.

Duke u nisur nga mënyra si është ndërtuar struktura organizative e njësive administrative/lagjeve të Bashkisë Kamëz, zyrtarët e vlerësimit do të gjenden në linjën vertikale të



administron procesin duke bashkëpunuar me zyrtarët e vlerësimit, me qëllim që procedura të realizohet në mënyrë korrekte.

✓ *Procedura e vlerësimit për disa nëpunës nuk ka përfunduar, pasi nuk është plotësuar ndarja “D” e formularit, e titulluar “Nënshkrimi”.*

Nga verifikimi i Formularëve të vlerësimit të administruar në dosjen e çdo nëpunësi civil, grupi i punës konstatoi se, në disa raste zyrtarët e vlerësimit nuk kanë plotësuar ndarjen D, të titulluar Nënshkrimi.

Në këtë rast bëhet fjalë për vlerësimet e kryera për nëpunësit:

1. \*\*\*\*\*, “Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”;
2. \*\*\*\*\*, “Specialist në Sektorin e Strehimit”;
3. \*\*\*\*\*, “Koordinator për të drejtën e informimit të publikut”;
4. \*\*\*\*\*, “Specialist i PAK, Lagjja Bathore”.

Në të gjitha këto raste, zyrtarët e vlerësimit nuk kanë përmbushur kërkesat e parashikuara nga pika 8, Kreu IV, i VKM nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar, ku parashikohet se:

*“Ndarja D plotësohet nga zyrtari raportues/ kundërfirmues/ autorizues/ eprori direkt për anëtarët e TND-së dhe për nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore dhe nëpunësi pas takimit për diskutimin e vlerësimit përfundimtar”.*

Duke mospërmbyllur procedurën e vlerësimit, njësia e burimeve njerëzore dhe zyrtari raportues respektiv nuk kanë realizuar një nga hapat më të rëndësishëm të procedurës që është nënshkrimi i formularit.

Në këto raste, njësia e burimeve njerëzore nuk duhet të administronte në dosjen e personelit formularët e vlerësimit por t’ia kthente zyrtarit raportues, në të njëjtën kohë të informonte zyrtarët/menaxherët mbi detyrimet e tyre në këtë proces, si dhe afatin brenda të cilit duhet ta përmbushnin këtë detyrë.

Procedura e vlerësimit konsiderohet e përfunduar vetëm kur janë plotësuar në mënyrë të saktë dhe të qartë të gjitha të dhënat që kërkohen në ndarjet e formularit dhe kur është nënshkruar nga të gjithë zyrtarët e vlerësimit dhe nëpunësi i vlerësuar.

**Konkluzion:** Në përfundim të analizës së parregullsive të trajtuara në këtë pikë të raportit, Komisioneri vlerëson se:

- Institucioni i mbikëqyrur të përmbyllë procedurën e vlerësimit për nëpunësit \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , për periudhën korrik - dhjetor, viti 2021, në përputhje me procedurat e hollësishme të përcaktuara në VKM nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar.

Mosplotësimi i të gjitha ndarjeve të formularit të vlerësimit, për nëpunësit e përmendur në këtë pikë të raportit është përgjegjësi e zyrtarit raportues i cili ka përgjegjësi të veçantë në realizimin e procedurës së vlerësimit dhe e Njesisë së burimeve njerëzore e cila paraqitet në rolin e administrimit të procesit.

Zyrtari raportues zhvillon takime të rregullta dhe bashkëbisedon me nëpunësin lidhur me realizimin e objektivave dhe profesionalizmin e treguar. Më tej ai diskuton me Zyrtarin kundërfirmues dhe Zyrtarin autorizues lidhur me nivelin e vlerësimit. Në kreun IV, të VKM nr. 109, dt. 26.2.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar është përcaktuar në mënyrë të shprehur se ndarjet A, B, C, Ç, D të formularit të vlerësimit plotësohen nga zyrtari raportues.

- Njësia e burimeve njerëzore është përgjegjëse për parregullsitë e evidentuata në këtë pikë të raportit pasi në këto raste, Formularët e vlerësimit nuk duhet ti administronte në dosjen e personelit por t’ia kthente zyrtarit raportues përkatës dhe në të njëjtën kohë të informonte zyrtarët/menaxherët mbi detyrimet e tyre në këtë proces si dhe afatin brenda të cilit duhet ta përmbushnin këtë detyrë, ç’ka duhet të jetë në vëmendje të saj në të ardhmen.

✓ *Të dhënat që kërkohen në ndarjet/nëndarjet përkatëse të formularit në disa raste nuk janë plotësuar, në disa raste janë plotësuar pjesërisht ose në mënyrë të pasaktë.*

Më konkretisht konstatojmë si më poshtë:

**Së pari**, struktura dhe organika në fuqi e institucionit të mbikëqyrur ka të parashikuar Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Publike e cila ka në përbërje Drejtorinë e Projekteve dhe Investimeve; Drejtorinë e Prokurimit Publik dhe IT si dhe sektorët përkatës (Sektori i Investimeve dhe Monitorimit të Infrastrukturës; Sektori i Projektimit dhe Sektori i Rindërtimit). Por, në formularët e vlerësimit të punës për specialistët dhe përgjegjësit e sektorëve, drejtoria e përgjithshme nuk është plotësuar. Për shkak të

mosplotësimin në mënyrë të saktë dhe të plotë të linjës hierarkike organizative që mbikëqyr nëpunësin që vlerësohet, më pas nëpunësit e përfshirë në procesin e vlerësimit Zyrtari raportues, Zyrtari kundërfirmues dhe Zyrtari autorizues janë caktuar në mënyrë të gabuar, e për pasojë procedura e vlerësimit nuk është kryer në mënyrë korrekte.

**Së dyti**, nëpunësit e emëruar për herë të parë në kategorinë ekzekutive i janë nënshtruar periudhës së provës që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit. Këta nëpunës e kanë përmbyllur periudhën e provës gjatë vitit kalendarik sipas afateve përkatëse të secilit dhe më pas janë përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë që kryhet çdo 6 muaj. Konstatohet se, në këto raste periudha e vlerësimit është shënuar e plotë janar - qershor, korrik – dhjetor, ndërkohë që periudha e vlerësimit përfundon në datën që vjen menjëherë pas datës së përfundimit të periudhës së provës dhe vazhdon deri në përfundim të periudhës së mbetur të vlerësimit e cila sipas rastit është data 30 qershor ose 31 dhjetor e vitit kalendarik përkatës. Prandaj në të gjitha këto raste zyrtari raportues e ka plotësuar gabim periudhën e vlerësimit.

**Së treti**, në disa raste nëpunësit që kanë vepruar në cilësinë e zyrtarit raportues nuk kanë plotësuar në mënyrë të saktë nëse vlerësimi i punës është:

- Vlerësim 6 mujor, *(vlerësim që përsëritet çdo 6 muaj sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 62 të ligjit)*;
- Vlerësim vjetor *(vlerësim për periudhën e provës që kërkon pika 4, neni 24 i ligjit dhe germa b), pika 6, kreu VI i VKM nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar)*;
- Rishikim i ndërmjetëm, apo vlerësimi është bërë për ndonjë qëllim tjetër.

Duke mos përcaktuar qartë qëllimin për të cilin është kryer procedura e vlerësimit, Zyrtari raportues përkatës *(nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën hierarkike organizative, nëpunësin e vlerësuar)*, nuk ka zbatuar kërkesat e pikës 3, të Kreut IV, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, ku thuhet se “Ndarja A plotësohet nga zyrtari raportues/epropri direkt për anëtarët e TND-së dhe për nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore në fillim të periudhës së vlerësimit. Të gjitha të dhënat personale të nëpunësit civil mbahen në shënim në mënyrë korrekte dhe përcaktohet qartë nëse vlerësimi është analizë 6 mujore e punës, është analizë e ndërmjetme e punës ose nëse bëhet për ndonjë qëllim tjetër”.

**Konkluzion:** Duke marrë parasysh rrethanat e parashtruara në këtë pikë të raportit, arrihet në konkluzionin që, nëpunësit të cilët janë të përfshirë në procesin e vlerësimit të

rezultateve në punë, duhet të kujdesen që të përmbyllin procesin për 6 mujorin e dytë të vitit 2021, duke respektuar të gjitha procedurat e hollësishme të përcaktuara në vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, si dhe të ndjekin procesin për të respektuar procedurat dhe afatet edhe për vlerësimet 6 mujore, të vitit 2022. (*Në rastin e institucionit të mbikëqyrur, nëpunës të përfshirë në procesin e vlerësimit janë nëpunësit e emëruar në pozicionet përgjegjës sektori, drejtor drejtorie, drejtor drejtorie të përgjithshme, titullar institucioni si dhe njësia e burimeve njerëzore*).

- Në përfundim të procesit, formulari i vlerësimit për çdo nëpunës civil, duhet të përfshihet në dosjen e personelit dhe Regjistrin Qendror të Personelit, siç parashikohet në pikën 1, Kreu II, të VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020, dhe pikën 18, të Kreut II, të VKM-së nr.109, datë 26.02.2014, i ndryshuar.
- Gjithashtu, formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, i cili plotësohet çdo 6 muaj brenda vitit kalendarik, apo në përfundim të periudhës së provës, është dokument që plotësohet dhe miratohet nga nëpunësit e ngarkuar me kompetencën e vlerësimit dhe në këtë rast, duhet të plotësohen në mënyrën e duhur të gjitha ndarjet dhe elementet formalë të kërkuara nga formulari i vlerësimit.

Për këtë arsye, nëpunësit e ngarkuar me kompetencën e vlerësimit të rezultateve në punë, duhet të kujdesen që:

- ✓ Të plotësohen Formularët e vlerësimit me të dhënat që kërkohen në ndarjet e dallueshme A, B, C, Ç, D e DH, duke respektuar në mënyrë të përpiktë të gjitha udhëzime e dhëna në Kreun IV, të titulluar Formulari i vlerësimit, të VKM nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar.
- ✓ Nënndarjet e ndarjes C, komentet e zyrtarit raportues/shpjegime të plotësohen me komente që tregojnë aftësi/përparësi të veçanta që ka nëpunësi apo fushat ku ai duhet të bëjë përmirësime.
- ✓ Në ndarjen “*Vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë*”, të përzgjidhet vlerësimi i duhur dhe të vendoset shenja përkatëse.
- ✓ Zyrtari raportues/ Zyrtari kundërfirmues/ Zyrtari autorizues, në hapësirat përkatëse të identifikojnë të plotë emrin, mbiemrin dhe pozicionin e punës sipas funksionit që ata kryejnë, më pas të vendosin firmën dhe datën e nënshkrimit. Më tej, formulari i vlerësimit duhet t’i paraqitet nëpunësit të vlerësuar, që të plotësojë në



ndarjen përkatëse deklarimin jam dakord/ nuk jam dakord dhe vendosjen e emrit, mbiemrit dhe nënshkrimit të tij në ndarjen përkatëse.

- ✓ Në rastin e rivlerësimit të nëpunësit, vendimi përfundimtar për vlerësimin e rezultateve në punë duhet të jetë i arsyetuar në ndarjen përkatëse të formularit. Pas plotësimit të kësaj ndarje nga zyrtari autorizues, procesi duhet të vijojë me plotësimin e deklarimit jam dakord/ nuk jam dakord nga nëpunësi dhe vendosjen e nënshkrimit prej tij.
- ✓ Formularët e vlerësimit të plotësuar dhe të nënshkruar, të administrohen në dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil.
- ✓ Nëpunësit e ngarkuar me detyrën e vlerësimit, duhet të bëjnë plotësime të natyrës teknike/ materiale në formularët e vlerësimit të punës, me qëllim formalizimin e tyre, si çdo dokument tjetër zyrtar.

Për sa i takon mënyrës së vlerësimit, sfida e aktorëve të këtij procesi është përcaktimi i objektivave të qarta dhe të matshme, si dhe ndjekja e ecurisë së nëpunësve civilë nga ana e eprorit direkt, gjatë realizimit të objektivave dhe detyrave të tyre funksionale, me qëllim që vlerësimi i punës të vendoset në parametra sa më objektive.

\*\*\*

✓ ***Të dhëna në lidhje me nivelet e vlerësimit:***

Për të paraqitur nivelet e vlerësimit të përdorura për periudhën e fundit të vlerësimit, periudha korrik - dhjetor, viti 2021, grupi i punës i është referuar **11** rasteve të vlerësimit të vlerësuara si procedura të rregullta (*në këto raste është respektuar linja hierarkike e zyrtarëve të vlerësimit dhe është plotësuar ndarja D Nënshkrimi*). Në këtë rast bëhet fjalë për vlerësimet e kryera për nëpunësit \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*.

Duke patur parasysh katër nivelet e vlerësimit “shumë mirë”, “mirë”, “kënaqshëm” dhe “jokënaqshëm”, të parashikuar në pikën 13, Kreu II, i VKM nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar, vlerësimi përfundimtar i nëpunësve, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 6 Niveli i vlerësimit për gjashtëmuja të vitit 2021

**Korrik - Dhjetor 2021**

Niveli i vlerësimit përfundimtar	<i>Shumë mirë</i>	<i>Mirë</i>	<i>Kënaqshëm</i>	<i>Jo kënaqshëm</i>
Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel	4	7	-	-
<b>Totali</b>	<b>11</b>			

Në këto raste zyrtarët e vlerësimit dhe nëpunësit e vlerësuar kanë qenë dakord me vlerësimin.

\*\*\*

✓ ***Kërkesa/Informacione në lidhje me procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë të paraqitura nga nëpunës të institucionit Bashkia Kamëz.***

Në kuadër të mbikëqyrjes, u verifikuan edhe rastet e nëpunësve të Bashkisë Kamëz, të cilët kanë kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për të rivendosur gjendjen e ligjshmërisë në lidhje me realizimin e procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se pranë Komisionerit janë regjistruar ankesat/informacionet si më poshtë:

**1. Kërkesa/informacioni i paraqitur nga nëpunësi \*\*\*\*\* , ish Specialist Jurist, në Drejtorinë Juridike, në Bashkinë Kamëz, regjistruar në zyrën e protokollit të Komisionerit me nr. 178 prot., datë 18.2.2022.**

Me administrimin e kartelës shoqëruese të praktikës me nr. 178 prot., datë 18.02.2022, “Ankesë në lidhje me vlerësimin e punës”, grupi i punës i ngarkuar për kryerjen e mbikëqyrjes në institucionin Bashkia Kamëz, kreu verifikimet e rastit, nga ku rezultoi se:

Nëpunësi, \*\*\*\*\* , me aktin nr. 598, (nr. 3/4 prot.), datë 25.10.2019, është emëruar për herë të parë në shërbimin civil, (emëruar nëpunës civil në periudhë prove), në pozicionin “Specialist Jurist”, në Drejtorinë Juridike, në Bashkinë Kamëz. Më pas, me aktin nr. 542 (542 prot.), datë 26.10.2020, të drejtuesit të bashkisë, ai është ngarkuar (komanduar) që të kryejë përkohësisht si detyrë shtesë edhe detyrën e Drejtorit të Drejtorisë të Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik.

Me aktin nr. 3004 prot., datë 24.03.2021, të nxjerrë nga titullari i institucionit, nëpunësi \*\*\*\*\*\*, është konfirmuar nëpunës civil dhe ka vazhduar të kryejë detyrën “*Specialist Jurist*” dhe detyrën shtesë si drejtor juridik, deri në paraqitjen e dorëheqjes nga detyra në datën 11.06.2021. (*Kërkesë për dorëheqje nr. 6127 prot., datë 11.06.2021, miratuar me urdhrin nr. 319 (319 prot., datë 11.06.2021, të Kryetarit të Bashkisë).*)

Akti për miratimin e dorëheqjes është bërë objekt i shqyrtimit administrativ pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, regjistruar me Nr. 4235 Regjistri, datë 07.10.2021, dhe është zgjidhur me vendimin nr. 3505, datë 10.12.2021. Kundër këtij vendimi, Bashkia Kamëz ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, dhe statusi i çështjes është në pritje për shqyrtim (*Ankim nr. 126 prot., datë 06.01.2022).*)

Në përmbajtjen e kërkesës/informacionit të paraqitur pranë Komisionerit, nëpunësi parashtron pretendime se njësia përgjegjëse e Bashkisë Kamëz, nuk i ka kryer atij vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën e vlerësimit korrik - dhjetor të vitit 2020. Këtë fakt ai e konsideron si aspekt të një menaxhimi jo të mirë të shërbimit civil, pasi sa kohë që nuk ka vlerësimin e punës për këtë periudhë, ai nuk mund të konkurrojë për procedurat e lëvizjes paralele dhe ato të ngritjes në detyrë. Mbështetur në këto pretendime, ai kërkon ndërhyrjen e Komisionerit për të rivendosur gjendjen e ligjshmërisë duke marrë masa për kryerjen e procedurës së vlerësimit për 6 mujorin e dytë të vitit 2020, (*për periudhën e vlerësimit korrik - dhjetor, viti 2020).*)

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, nëpunësi \*\*\*\*\*\*, nëpërmjet procedurave të konkurrimit, me **aktin nr. 598 (3/4 prot.), datë 25.10.2019**, është emëruar për herë të parë në shërbimin civil në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Drejtorinë Juridike, në Bashkinë Kamëz.

Në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, është parashikuar në mënyrë të shprehur se:

*“1. Nëpunësi, që emërohet për herë të parë në shërbimin civil, i nënshtrohet një periudhe prove që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit.*

*2. Gjatë periudhës së provës nëpunësi kryen ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s dhe kryen detyrat nën kujdesin e një nëpunësi të vjetër civil të së njëjtës kategori ose kategorie më të lartë.*

*3. Në fund të periudhës së provës, institucioni, ku nëpunësi është i emëruar, vendos:*

*a) Konfirmimin e nëpunësit;*

*b) Zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 muaj të tjerë, nëse për arsye të justifikuara ka qenë i pamundur vlerësimi i plotë i nëpunësit;*

c) *Moskonfirmimin e nëpunësit.*

4. *Vendimi, sipas pikës 3 të këtij neni, bazohet në çdo rast në vlerësimin e rezultateve individuale në punë dhe në rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s”.*

Referuar datës së aktit të emërimit në shërbimin civil, **datë 25.10.2019** dhe parashikimeve të pikës 1, të nenit 24 të cituar më lartë, për nëpunësin **\*\*\*\*\***, periudha e provës ka filluar në datën 25.10.2019 dhe duhet të përfundonte në datën 24.11.2020. Por faktikisht, nëpunësi në fjalë, gjatë periudhës 17 - 24 nëntor 2020, ka ndjekur trajnimin e detyrueshëm pranë ASPA-s dhe çertifikata e përfundimit të kursit të trajnimit, i është vënë në dispozicion njësisë të burimeve njerëzore të Bashkisë Kamëz, në datën 25.01.2021. Më tej, periudha e provës ka përfunduar në datën 24.3.2021, datë në të cilën ka dalë vendimi i konfirmimit të nëpunësit civil nr. 3004 prot., datë 24.03.2021. *(Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (Drejtoria e Trajnimit), me shkresën nr. 106 prot., datë 20.01.2021, i ka dërguar Bashkisë Kamëz çertifikatën e përfundimit të trajnimit të detyrueshëm të nëpunësit \*\*\*\*\* , me nr. G/11/2020PV. Kjo shkresë dhe çertifikata bashkëlidhur saj, janë protokolluar pranë institucionit të mbikëqyrur me nr. 671 prot., datë 25.01.2021).*

Bazuar në këto të dhëna, në lidhje me pretendimin e parashtruar nga nëpunësi **\*\*\*\*\***, se nuk i është kryer vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën e vlerësimit korrik - dhjetor, viti 2020, grupi i punës sqaron se, gjatë kësaj periudhe nëpunësit i vazhdonte periudha e provës e cila është përmbyllur me daljen e akti të konfirmimit të nëpunësit civil në datën 24.03.2021.

Nga verifikimi i dokumentacionit që materializon realizimin e procedurës së konfirmimit si nëpunës civil rezulton se, në dosjen e personelit të nëpunësit **\*\*\*\*\***, është administruar:

- Çertifikata e ASPA-s për përfundimin e trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civilë në periudhë prove me nr. G/11/2020PV, vlerësuar me 18 pikë;
- Formulari i vlerësimit të punës për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese datë 10.8.2020;
- Vendim konfirmimi nëpunës civil nr. 3004 prot., datë 24.3.2021.

Nga përmbajtja e Formularit të vlerësimit rezulton se, periudha e vlerësimit është shënuar janar - qershor 2020 dhe ndarja D “*Nënshkrimi*”, nuk është plotësuar nga zyrtarët e vlerësimit. Në këtë rast, konstatohet se:

*Së pari*, periudha e vlerësimit nuk përfshin gjithë periudhën e provës e cila ka filluar në datën 25.10.2021 dhe është zgjatur deri në datën 24.3.2021.

*Së dyti*, procedura e vlerësimit nuk është përmbyllur me nënshkrimin e ndarjes D të titulluar “*Nënshkrimi*”.

Këto fakte tregojnë për parregullsi në administrimin e shërbimit civil lidhur me kryerjen e vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës.

Më tej, parregullsi në administrimin e shërbimit civil është edhe komandimi i nëpunësit \*\*\*\*\* në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik, në Bashkinë Kamëz (*akti nr. 542, datë 26.10.2020, i drejtuesit të bashkisë*), pasi nëpunësi në fjalë ishte nëpunës civil në periudhë prove dhe gjatë kësaj periudhe si nëpunësi edhe institucioni duhet të përmbushnin detyrimet e periudhës së provës.

Me përmbylljen e periudhës së provës për nëpunësin në fjalë, si për të gjithë nëpunësit e tjerë civilë, institucioni kishte detyrimin që të zbatonte procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e mbetur të 6 muajit të parë të vitit kalendarik 2021, që korespondon me periudhën 24.03.2021 - 10.06.2021 (2 muaj e 17 ditë). Në rastin konkret vlerësimi do të bëhej vetëm për një pjesë të periudhës së vlerësimit për shkak se në datën 24.03.2021, nëpunësi ka përmbyllur periudhën e provës dhe më pas në datën 11.06.2021, ka përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil nëpërmjet dorëheqjes.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se parregullsi në administrimin e shërbimit civil janë lejuar edhe gjatë realizimit të procedurës së lirimit nga detyra të nëpunësit \*\*\*\*\*. Këto parregullsi janë përcaktuar dhe vlerësuar në pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me Nr. 4235 Regjistri, datë 07.10.2021 Regjistrimi dhe Nr. 3505 Vendimi, datë 10.12.2021 Vendimi.

**Konkluzion:** Në përfundim të analizës së këtij rasti, Komisioneri arrin në konkluzionin si më poshtë:

- Për periudhën e vlerësimit korrik - dhjetor, viti 2020, nëpunësi \*\*\*\*\* nuk mund të ketë vlerësim pune që përsëritet çdo 6 muaj të vitit kalendarik, pasi për periudhën nga 25.10.2019 - 24.3.2021, ai ka qenë nëpunës civil në periudhë prove. Vlerësimi i rezultateve në pune që përsëritet çdo 6 muaj të vitit kalendarik, realizohet për nëpunësit civilë të konfirmuar.
- Institucioni të plotësojë dokumentacionin e procedurës së konfirmimit nëpunës civil, të nëpunësit \*\*\*\*\* duke i kryer atij një vlerësim për gjithë kohën sa ka zgjatur periudha e provës.

Në ndarjen A, nëndarja: Periudha e vlerësimit, periudha e vlerësimit do të shënohet nga data 25.10.2019, deri në datën 24.3.2021. Më tej, në nëndarjen: Lutemi shënoni sipas rastit: Vlerësim vjetor i rezultateve në punë - Rishikim i ndërmjetëm - Tjetër (Specifiko), do të plotësohet rasti “*Tjetër (Specifiko)*” ku do të përcaktohet qartë

*“Vlerësim i rezultateve në punë për periudhën e provës”*. Vlerësimi do të kryhet në përputhje me procedurat e hollësishme të përcaktuara në VKM nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar dhe do të administrohet në dosjen e personelit të nëpunësit duke zëvendësuar vlerësimin e kryer në datën 10.8.2020. Vlerësimi i mëparshëm do të hiqet nga dosja e nëpunësit.

- Në kushtet ku, në datën 11.6.2021, kërkuesi ka përfunduar marrëdhënien e punës me dorëheqje dhe dorëheqja është ankimuar prej tij në gjykatën kompetente, në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, të vijohet sipas urdhërimit të gjykatës.
- Eprori direkt, në çdo rast të ndodhjes në situatat e parashikuara nga germa b), pika 7, Kreu VI, i VKM nr. 243, datë 18.03.2018, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar, duhet të nxjerrë vendim për zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme deri në 6 (gjashtë) muaj.
- Për parregullsitë në administrimin e shërbimit civil të evidentuara në këtë pjesë të raportit, janë përgjegjës njësia e burimeve njerëzore dhe titullari i institucionit.

**2. Kërkesa/informacioni i paraqitur nga punonjësja Enkeleda Baloshi, Përgjegjëse e Sektorit të Integritit të BE, në Bashkinë Kamëz, regjistruar në zyrën e protokollit të Komisionerit me nr. 204 prot., datë 02.03.2022.**

Me administrimin e kartelës shoqëruese të praktikës me nr. 204 prot., datë 2.3.2022, *“Ankesë për vlerësimin e punës për periudhën 1.7.2021 - 31.12.2021”*, grupi i punës i ngarkuar për kryerjen e mbikëqyrjes në institucionin Bashkia Kamëz, kreu verifikimet e rastit, nga ku rezultoi se:

Kërkuesja \*\*\*\*\*, është e punësuar pranë Bashkisë Kamëz duke kryer detyra të ndryshme në kategorinë ekzekutive dhe të ulët drejtuese. *Në të gjitha rastet akti i emërimit në detyrë është nxjerrë nga kryetari i bashkisë.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit, aktet e nxjerra për punonjësen \*\*\*\*\*, për emërim në detyrë, i kemi paraqitur në mënyrë kronologjike, si më poshtë:

- Urdhër nr. 305 (305 prot.), datë 23.09.2015, *“Për emërimin në detyrë”*, \*\*\*\*\*, emërohet në pozicionin *“Inspektore e tatimeve në terren”*, në Bashkinë Kamëz.
- Urdhër nr. 17 (17 prot.), datë 05.01.2016, *“Për lëvizje në detyrë”*, punonjësja \*\*\*\*\* me detyrë *“Specialiste e Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren”*,

kalon në pozicionin “*Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë*”, Njësia Administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz.

- Urdhër nr. 200 (200 prot.), datë 01.04.2016, “*Për largim nga detyra*”, punonjësja \*\*\*\*\*, për arsye personale largohet nga detyra si “*Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë*”, pranë Njësisë Administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz.
- Urdhër nr. 383 (nr. 383 prot.), datë 01.08.2016, “*Për emërim në detyrë*”, \*\*\*\*\*, emërohet në pozicionin “*Specialiste e MTPM*”, në Drejtorinë e MTPM-së, Bordi i Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, Bashkia Kamëz.
- Urdhër nr. 46 (46 prot.), datë 18.01.2017, “*Për lëvizje në detyrë*”, punonjësja \*\*\*\*\*, me detyrë “*Specialiste e MTPM*”, në Drejtorinë e MTPM-së, kalon në pozicionin “*Përgjegjëse*” pranë Drejtorisë të Shërbimeve Publike, Dekorit dhe Strehimit, në Bashkinë Kamëz.
- Urdhër nr. 123 (123 prot.), datë 09.05.2018, “*Për lëvizje në detyrë*”, punonjësja \*\*\*\*\*, me detyrë detyrë “*Përgjegjëse*” pranë Drejtorisë të Shërbimeve Publike, Dekorit dhe Strehimit, emërohet “*Specialiste e Shërbimeve Publike*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në Bashkinë Kamëz. Urdhër nr. 227 (227 prot), datë 25.07.2018, “*Pezullim nga detyra*”, punonjësja \*\*\*\*\*, pezullohet nga detyra “*Specialiste e Shërbimeve Publike*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Bashkia Kamëz, me motivacionin “*Mospresencë në detyrë në mënyrë të përsëritur*”, deri në një urdhër të dytë. Urdhër nr. 271 (271 prot), datë 06.09.2018, “*Mbi revokimin e urdhrit nr. 227, datë 25.07.2018*”, \*\*\*\*\*, rikthehet në detyrën “*Specialiste e Shërbimeve Publike*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në Bashkinë Kamëz.
- Urdhër nr. 188 (188 prot.), datë 04.03.2019, “*Për lëvizje në detyrë*”, punonjësja \*\*\*\*\*, në detyrën “*Specialiste e Shërbimeve Publike*”, emërohet “*Përgjegjëse pranë Drejtorisë të Shërbimeve Publike*”, në Bashkinë Kamëz.
- Urdhër nr. 638 (638 prot.), datë 15.11.2019, “*Për transferim të përkohshëm në detyrë*”, punonjësja \*\*\*\*\*, në detyrën “*Përgjegjëse pranë Drejtorisë të Shërbimeve Publike*”, transferohet në detyrën “*Përgjegjëse e Sektorit të Integritetit Europian dhe Projekteve*”, në Bashkinë Kamëz, deri në një urdhër të dytë. Urdhër nr. 638/1 (638/1 prot.), datë 06.01.2020, “*Mbi revokimin e urdhrit nr. 638, datë 15.11.2019*”, i kryetarit të bashkisë.
- Urdhër nr. 23 (23 prot.), datë 08.01.2020, “*Për lëvizje në detyrë*”, punonjësja \*\*\*\*\*, në detyrën “*Përgjegjëse pranë Drejtorisë të Shërbimeve Publike*”, emërohet “*Përgjegjës i Sektorit të Integritetit në BE*”, Bashkia Kamëz.

Grupi i punës konstaton se, në të gjitha rastet, aktet për emërimin apo kalimin në një detyrë tjetër të punonjësës \*\*\*\*\*; kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm. Në rastin e punonjësës në fjalë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të germa a) dhe germës ç), të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

**Konkluzion:** Në përfundim të analizës së këtij rasti, arrihet në konkluzionin se, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, emërimi për herë të parë në shërbimin civil dhe zhvillimi i karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë bëhet vetëm nëpërmjet procesit të konkurrimit. Për punonjësën \*\*\*\*\*; sa kohë që nuk janë zbatuar këto procedura, ajo në asnjë rast nuk e ka përfituar statusin e nëpunësit civil. Për këtë arsye, ndaj saj nuk mund të zbatohen procedurat e vlerësimit të rezultateve në punë të parashikuara në nenin 62, të ligjit dhe Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, pasi këto procedura zbatohen vetëm për nëpunësit civilë.

Për rregullimin e ligjshmërisë në këtë rast, institucioni i mbikëqyrur duhet të veprojë si më poshtë:

- Të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 23 (23 prot.), datë 08.01.2020, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, për emërimin e punonjësjes \*\*\*\*\*; në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Integritit në BE”, në Bashkinë Kamëz dhe të rregullohen pasojat, duke i ndërprerë punonjësës marrëdhëniet financiare me institucionin.
- Institucioni i Bashkisë Kamëz, të shfuqizojë aktin nr. 9400 prot., datë 06.10.2021, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, për konfirmimin si nëpunës civil të \*\*\*\*\*; në pozicionin “Përgjegjëse” pranë Drejtorisë të Integritit të BE-së dhe Projekteve të Huaja, Bashkia Kamëz. Ky pozicion pune të shpallet vend i lirë, për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.
- Punonjësja \*\*\*\*\*; është emëruar në shërbimin civil në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në këto kushte, në rastin e saj institucioni, nuk ka detyrim që të zbatojë



procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë të parashikuar nga neni 62, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimi nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

## **VII. Roli dhe funksioni i njësisë përgjegjëse, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në administrimin e shërbimit civil**

Në kuptim të nenit 4, germa f), të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore për institucionet e qeverisjes vendore, paraqitet në cilësinë e njësisë përgjegjëse. Më tej, në nenin 10, të po këtij ligji, përcaktohet se çdo institucion në fushën e veprimit të këtij ligji, krijon njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore. Njësia e burimeve njerëzore është përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet shprehimisht në këtë ligj që një vendim/akt administrativ i caktuar, që ka të bëjë me marrëdhëniet e shërbimit civil, është në kompetencën e një nëpunësi apo një trupe tjetër posaçërisht të krijuar sipas këtij ligji.

Kjo njësi përbën mekanizmin që luan një rol të rëndësishëm në administrimin e shërbimit civil, rol i cili buron nga përcaktimet specifike të nenit 10, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vijon me kompetencat e përcaktuara shprehimisht gjatë zhvillimit të procedurave ligjore që parashikojnë dispozitat në vijim të këtij ligji.

Njësia e burimeve njerëzore, gjatë ushtrimit të kompetencës për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit, bashkërendon punët me njësitë e tjera pjesë e strukturës së institucionit me qëllim që të sigurohet zbatimi i parimeve të sanksionuara në ligjin e shërbimit civil dhe të respektohen procedurat ligjore të kërkuara për çdo institut të tij.

Nisur nga konstatimet e parashtruara në përmbajtje të këtij raporti, rezulton se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pranë Bashkisë Kamëz, duhet të kishte treguar më tepër përgjegjshmëri në zbatimin e detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, ku mund të përmendim mangësitë e konstatuara:

*Së pari*, gjatë procesit të hartimit dhe miratimit strukturës së institucionit, e cila shoqërohet me hartimin dhe miratimin e përkrahjeve të punës për pozicionet e shërbimit civil, njësia e burimeve njerëzore duhet të kishte kërkuar dhe orientuar personat e ngarkuar nga ligji, për përfundimin e kësaj procedure brenda afateve ligjore dhe marrjen e masave në rastet e mospërbushjes së detyrës prej tyre.

Së dyti, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Kamëz, jo më vonë se muaji shkurt, duhet të hartonte dhe të miratonte planin vjetor të pranimi në shërbimin civil, në përputhje me nenin 18, të Ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, dhe pikës 11, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 26.02.2014, “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”. Më tej, në përputhje me pikën 13, të kësaj VKM-je, njësia përgjegjëse, duhet të merrte masat për të publikuar planin vjetor të miratuar pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Së treti, sa i takon hapave të ndjekura nga njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues, si edhe të lartë drejtues nëpërmjet konkurrimit, rezulton se nuk janë respektuar kërkesat e nenit 22, 25, 26 dhe 32, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në lidhje me fazat e këtij procesi. Në mënyrë të detajuar problematikat e hasura gjatë zhvillimit të fazave të procedurave të konkurrimit janë pasqyruar në përmbajtje të materialit në nënçështjet përkatëse.

Së katërti, njësia përgjegjëse nuk ka ndjekur hapat ligjorë të parashikuar në nenin 24 dhe nenin 67, të Ligjit për shërbimin civil, në lidhje me deklarin e statusit të punësimit për herë të parë në shërbimin civil, “nëpunës civil në periudhë prove”, si dhe deklarin e statusit si “nëpunës civil”, për punonjësit e emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Së pesti, njësia e burimeve njerëzore nuk ka ndërmarrë hapat e kërkuar ligjor, në përditësimin dhe plotësimin e dosjeve të konkurrimit dhe dosjeve të personelit me dokumentacionin e nevojshëm.

**Konkluzion:** Në përfundim, për të gjitha sa është argumentuar më sipër dhe në përmbajtje të këtij materiali, vlerësohet se, njësia përgjegjëse duhet të luajë rol aktiv dhe të aplikojë të gjitha mjetet procedurale që i njej ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me qëllim që të sigurohet zbatimi korrekt i tij. Njësia duhet të tregojë një kujdes të veçantë gjatë aplikimit të institutit të rekrutimit, si një ndër institutet përmes së cilit bëhet pranimi për herë të parë në shërbimin civil, pasi pas aplikimit të këtij instituti, fillon aplikimi i të gjithë instituteve të tjera të ligjit, mbi nëpunësin civil.

Gjithashtu, nga njësia përgjegjëse kërkohet që në të ardhmen të garantojë ligjshmërinë e procedurave duke përdorur të gjitha mjetet ligjore që ligji i njej në rast të mospërmbushjes së detyrimeve nga personat përgjegjës për një proces ligjor të caktuar.

Referuar problematikave të konstatuara në veprimtarinë e njësisë përgjegjëse përsa i përket zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, shihet e dosmosdoshme thellimi i njohurive të punonjësve të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në këtë aspekt, për këtë qëllim duhet të ndiqen trajnimet e zhvilluara nga ASPA, në këtë fushë.

Institucioni i mbikëqyrur, për të gjitha sa është argumentuar më sipër, të analizojë shkaqet e moskryerjes së detyrave nga njësia përgjegjëse në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, duke evidentuar problematikat e hasura dhe të nxjerrë përgjegjësitë personale për secilin zyrtar. Në përfundim të këtij procesi të njoftohet Komisioneri, për masat e marra.

## **VIII. Dosjet e personelit**

### *a. Dosja e personelit*

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u këqyrën dosjet e personelit për **135** punonjës të emëruar në pozicione të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes, për të verifikuar nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe kërkesave të Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, në institucionin Bashkia Kamëz, u konstatua se, në dosjet personale të nëpunësve, administrohen dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (*diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave*), që në disa raste nuk ishte e noterizuar, referoju Aneks nr. 2, rubrika shënime, pjesë e raportit; dokumentet që vërtetojnë fillimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*), si dhe aktet që provojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimin (*në rastet kur është nxjerrë ky akt nga njësia përgjegjëse*), dokumenti që vërteton gjendjen gjyqësore (Dëshmi penalteti), si edhe vërtetimi i gjendjes shëndetësore (*Raporti Mjekësor*), të cilat duhet të rinovohen çdo vit, sipas 23, Kreu III, të VKM-së nr. 124, datë 17.02.2016, “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, i ndryshuar.

Në mënyrë të hollësishme këto akte janë materializuar në **aneksin nr. 2** “Respektimi i kërkesave të përgjithshme, sipas nenit 21, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil””, i ndryshuar, për punonjësit që janë Aktualisht, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në institucionin Bashkia Kamëz, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nga grumbullimi i të dhënave konstatohet se, në këtë institucion, në momentin e mbikëqyrjes ka gjithsej 147 pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, nga të cilat konstatohet:

- **135** pozicione pune janë të plotësuara;
- **12** pozicione pune janë të lira.
  - ✓ **85** punonjës janë të gjinisë femërore, ose 63 %;
  - ✓ **50** punonjës janë të gjinisë mashkullore, ose 37 %;

Për sa i përket arsimit të nëpunësve pranë Bashkia Kamëz, rezultojnë të kenë diplomë të studimeve të larta universitare, të marra nga Universitetet Publike apo Private të Republikës së Shqipërisë, nga të cilat:

- **119** nëpunës zotërojnë diplomë të arsimit të lartë të nivelit Master Shkencor/Profesional;
- **16** nëpunës zotërojnë diplomë të arsimit të lartë të nivelit Bachelor.

**Konkluzion:** Sa më sipër, vlerësohet se, dosjet e personelit nuk janë të sistemuara sipas kërkesave të akteve nënligjore që normojnë këtë fushë të shërbimit civil, si rrjedhim duhet të ndërmerren hapat e nevojshme nga njësia përgjegjëse, që secila dosje të ketë fletën prezantuese dhe dokumentacionin e kërkuar ligjor. Dosjet e personelit, u konstatua se, ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe në momentin e mbikëqyrjes administrohen nga Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, që është edhe njësia përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore për institucionin.

#### *b. Regjistri i personelit*

Regjistri Qendror i Personelit si sistemi që ruan dhe përpunon të dhënat elektronike për burimet njerëzore aktive në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, është krijuar dhe administrohet nga Departamenti i Administratës Publike.

Institucioni i mbikëqyrur, Bashkia Kamëz, ende nuk ka akses në sistem për të bërë plotësimin dhe përditësimin e të dhënave të parashikuara në lidhjen 3, “*Administratorët dhe përdoruesit e RQP-së dhe platformës së bashkëpunimit “administrata.al”, të drejtat dhe detyrimet*”, që i bashkëlidhet Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”.

Për këtë arsye duhet të kërkojnë asistencën e Departamentit të Administratës Publike, në rolin e institucionit përgjegjës në menaxhimin e platformës *administrata.al*.

\*  
\*   \*  
\*

Këto ish-in rrethanat e konstatuara nga grupi i punës gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin Bashkia Kamëz, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësi përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Aktet administrative që dokumentojnë procesin e mbikëqyrjes në institucionin Bashkia Kamëz, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat si më poshtë:

**Aneksi 1** “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punojnë në pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin Bashkia Kamëz*”.

**Aneksi 2** “*Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin Bashkia Kamëz*”.

**Tabela nr. 1** “*Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të institucionit Bashkia Kamëz. (Periudhat e vlerësimit janar - qershor; korrik - dhjetor, viti 2021, verifikimi në subjekt në qershor 2022)*”.

## K O M I S I O N E R I

**Pranvera STAKOSHA**